

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.135 TETOR 2019



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku


DESIGN

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPESHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Tetor, 2019



Ditë pelegrinazhi në teqenë e Frashërit



***E**shtë e vështirë që kur merr udhën drejt teqesë së famshme të Frashërit në Përmet, të shkëputesh nga meditimet për historinë e këtij objekti bektashian, për kontributin e dervishëve dhe baballarëve që kanë shërbyer këtu e kanë lënë gjurmë si klerikë...*



Ditë pelegrina e Fras



Nga Kujtim BORIÇI

Është e vështirë që kur merr udhën drejt teqesë së famshme të Frashërit në Përmet, të shkëputesh nga meditimet për historinë e këtij objekti bektashian, për kontributin e dervishëve dhe baballarëve që kanë shërbyer këtu e kanë lënë gjurmë si klerikë, mësimsdashës e atdhetar; nga kontributet e djemve të këtij fshati, poetit të shquar bektashian Naim Frashëri, vëllezërve të tij,

Abdyli e Samiu; nga roli që ka luajtur ky objekt në historinë e bektashizmit në Shqipëri e më gjerë. Për më tepër, kur udhëtimi lidhet me një ditë të shënuar, ditën e pelegrinazhit tradicional vjetor. Kemi marrë rrugën mes kthesave të shumta, mes një pylli masiv me pisha, fatmirësisht të pa dëmtuar, mes një karvani automjetesh që lëviznin drejt teqesë së famshme, ku nuk mungojnë dhe besimtarë të shumtë, të hipur në kafshë apo në këmbë, që grupe-grupe, kanë të njëjtin pikëgrumbullim. Diku ndalojmë, mes një peizazi tepër mahnitës, në një lëndinë anës rrugës, të

Madhi në teqenë e Frashërit




rrethuar me pisha të mëdha hijerënda. Ka dhe disa pelegrinë, që për pak minuta shijojnë këtë bukuri të rrallë, dhuratë e Krijuesit dhe natyrës. Takojmë një të moshuar. Na thotë se është 83 vjeç dhe se quhet Sotir Thomallaraj, e se është nisur për në Frashër. Pas përshëndetjeve të zakonshme, e pyesim me shaka se si ai, i krishterë, shkon për derman në një objekt bektashian. Me dashamirësi por serioz, ai na përgjigjet: “Dëgjoni more djem! Ai është vend i shenjtë dhe ka një histori që do e kishte zili kushdo tjetër. Është një teqe ku njerëzit gjejnë prehje, qajnë

hallet e tyre, kuvendojnë me njeri-tjetrin, luten tek i Madhi Zot për më shumë shëndet, më shumë dashuri, më shumë mirësi e më shumë shpresë. Pavarësisht besimit, i krishterë, bektashi, katolik apo mysliman, Krijuesi i Plotfuqishëm, është një dhe vetëm një. Ne jemi vëllezër me njeri-tjetrin, pa dallim feje, apo gjinie, kemi të njëjtat halle e shqetësime. Ndaj unë vij këtu në teqenë e Frashërit çdo vit, në këtë datë të shenjtë. Vij dhe kam gjetur derman. Sivjet kam ardhur së bashku me nipin që prej vitesh është në emigracion, por që ka ardhur me pushime... Po Frashëri, kjo teqe, kanë histori. Këtu kanë lindur Frashërllinjte, poeti i madh mbarëkombëtar Naimi e vëllezërit e tij... Ka dhe një muze atje, por pak po kujdesen për ‘të dhe historinë e Frashërit qeveritarët që ikin e shkojnë... Kjo teqe ka qenë dhe çerdhe atdhetarie, çerdhe e gjuhës dhe të shkruarit shqip, e kështu do të ngelet..!’

...Sheshi dhe mjediset e teqesë së njohur të Frashërit, janë mbushur plot me besimtarë. Futen në mezare, bisedojnë me njeri-tjetrin, me klerikët e ardhur sot këtu, qajnë hallet e mbushen me shpresë e me besim për të ardhmen, u shtohet adhurimi për Krijuesin. Baba Hekurani, pret besimtarët, drejtuesit vendor, të ardhurit nga Përmeti, Gjirokastra, Berati, Vlora, Mallakastra, nga Tirana e të ardhur deri nga vende të ndryshme jashtë Shqipërisë ku punojnë e jetojnë, bashkëbisedon me ‘ta dhe përkujdeset që aktiviteti të shkojë sa më mirë.


Në një moment, na afrohet e na takon historiani Kastriot Bezati, autor, që mes të tjerave, ka shkruar jo pak për këtë teqe bektashiane, për teqetë tona në treva të ndryshme të vendit dhe për bektashizmin si tarikat që reflekton paqe, mirësi, dashuri e unitet mes njerëzve, pa dallim krahine, feje, race apo etnie. Ashtu i emocionuar e me preokupim, por dhe me një krenari, pasi është dhe vetë nga Përmeti, na shpreh dhe disa



shqetësime lidhur me këtë teqe, infrastrukturën e më gjerë. Shpreh shqetësimet, jep rrugët e zgjidhjes, duke e quajtur veten në çdo rast pjesë të atyre që do impenjohen për zgjidhjen. “...Shumë kanë ardhur sot, por duhet të ketë më shumë besimtarë bektashian e të tjerë. Se kjo teqe, ka histori si asnjë tjetër, ka historinë e atdhetarisë, histori arsimdashëse... Është shkruar për historinë e saj shekullore, dhe unë kam shkruar, por është pak për këtë mrekulli që kemi. Unë kam bërë një studim të ri për teqenë e Frashërit, për klerikët që kanë punuar e drejtuar këtu e, shpejt do ia dorëzoj Kryegjyshit Botëror. Por duhet shumë. Ja, këtu pranë, është dhe muzeu i vëllezërve Frashëri. Por ai duhet të gumëzhij çdo ditë e çdo orë, jo kështu... Për halle ekonomike, ky fshat e krahina, janë boshatisur, por historia këtu është e gjallë e kështu do të mbetet. Dhe pushtetarët vendorë duhet të bëjnë më shumë, të lehtësojnë komunikimin me këtë teqe. Ja rruga, me gjithë përkujdesjen, lë për të dëshiruar. Duhet asfaltuar, se dhe ndonjë distancë e madhe nuk

... Kjo teqe, ka histori si asnjë tjetër, ka historinë e atdhetarisë, histori arsimdashëse... Është shkruar për historinë e saj shekullore, dhe unë kam shkruar, por është pak për këtë mrekulli që kemi. Unë kam bërë një studim të ri për teqenë e Frashërit, për klerikët që kanë punuar e drejtuar këtu e, shpejt do ia dorëzoj Kryegjyshit Botëror. Por duhet shumë. Ja, këtu pranë, është dhe muzeu i vëllezërve Frashëri. Por ai duhet të gumëzhij çdo ditë e çdo orë, jo kështu... Për halle ekonomike, ky fshat e krahina, janë boshatisur, por historia këtu është e gjallë e kështu do të mbetet.

është. Po kjo kërkon ndjeshmëri, kërkon përgjegjësi e punë...” -shton mes të tjerave ai.
Ardhja e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë



së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili pritet nga baba Hekurani, bën që instiktivisht, besimtarët e shumtë të grumbullohen rreth tij e komunikojë gjatë mes tyre. Një mjedis sa mistik e miqësor, aq dhe prekës, besues e shpresëdhënës. Në situata të tilla, dhe urime e bekime që burojnë nga shpirtrat bektashianë, dhe ndonjë pikë lot që rrjedh natyrshëm nga sytë e ndonjërit (që janë shprehje adhurim e besimi nga zemra), krijon atë mjedis sa mistik e njerëzor, që vetëm besimi bektashian mund ta krijoj. Natyrshëm, grumbullimi i besimtarëve në sheshin e teqesë, pasohet me traditën e ceremonialit. Është Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj dhe klerikët e tjerë bektashianë të pranishëm, që së bashku, kanë bërë këndimin e lutjeve me rastin e ditës së ashures.

Ndërsa në vazhdim, në fjalën e përshëndetjes, Kryegjyshi Botëror Bektashian theksoi: "...Jam i lumtur sot që në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t'ju përshëndes të gjithëve ju besimtarëve, kryetaren e Bashkisë Përmet e përfaqësues të in-


stitucioneve të tjera, t'u uroj shëndet, fat e mbarësi në familjet tuaja. Zoti i Lartë qoftë me ju! Ardhja sot këtu, në ditën e ashures, në festën e përvitshme tradicionale e më shumë njerëzve, është një tregues për shtimin e besimtarëve bektashianë, rritjen e adhurimit e shpresës tek besimi ynë, tek udha e ndritur e Haxhi Bektash Veliut, tek nevoja për më shumë dashuri e respekt për njeri-tjetrin. Kjo teqe, është një teqe me tradita të njohura të atdhetarisë e dijes. Këtu ka lindur poeti bektashian Naim Frashëri e vëllezërit e tij, këtu atdhetarizmi ka qenë gjithmonë jo vetëm predikim i fesë sonë, por dhe materializim konkret. Naim Frashëri, emri me të cilin u rritën dhe edukuan breza të tërë shqiptarësh, është i lidhur ngushtë jo vetëm me gjuhën dhe kulturën shqipe, jo vetëm me universin e letrave shqipe, por edhe me vetë besimin e mrekullueshëm bektashian. Eposi madhështor i Qerbelasë, ardhur me besnikërinë dhe tragjizmin e penës naimiane, u recitua dhe këndua nëpër teqetë bektashiane të trevave shqiptare, duke

ushqyer fisnikëri, dliresi morale dhe hyjnore. Kjo vepër ende sot, mban në këmbë shpresat e miliona besimtarëve bektashianë. Frashëri është kryeqendra e diturisë që u dha shqiptarëve në zgjimin kombëtar, të vëllezërve Frashëri dhe gjithë rilindasit kombëtar për Shqipërinë. Abdyli, Samiu, Naimi dhe së fundmi Mid'hat Frashëri, ndonëse u rritën dhe edukuan larg kësaj toke, me shembullin e shkëlqyer të atdashedhurisë së tyre, dëshmon dhembshurinë e vatanit, dëshirën për ta parë atë sa më të mbarë, në udhë të Perëndisë. Teksa përkujtojmë e festojmë së bashku sot këtë ditë, është momenti t'u jemi mirënjohës e të kujtojmë dhe rolin e kontributin e klerikëve tanë që kanë punuar në këtë teqe, që nga baba Tahir Nasibi Skënderasi, baba Alushi, baba Abedin Ibro, baba Sheme, baba Mustafa Qerezi, baba Murati, baba Abaz Hilmi, baba Mehmet Zykej, baba Xhemal Shkëmbi etj. Frashëri mbetet qendra kulturore historike fetare prej motesh dhe shekujt nuk e zhbën, por forcojnë nga dita në ditë mësimet e vyera që lidhet në kohën, me vitet e ngjizjes së vetëdijes sonë kombëtare, kjo u shndërrua në vatër të dashurisë për Zotin, për Shqipërinë. Falënderoj me këtë rast dhe vëllanë tim,



baba Hekuranin, që nën shembullin e pasardhësve tanë, po punon që teqeja e Frashërit dhe të tjerat në këtë trevë, të mbajnë ndezur frymën e besimit e atdhetarisë, duke synuar rritjen e numrit të besimtarëve që afrohen me besimin tonë të shenjtë. Zoti ju bekoftë të gjithëve! Amin!”

Ndërsa kryetarja e Bashkisë, znj. Alma Hoxha, e zgjedhur para pak kohësh në këtë funksion, premton më shumë përkujdesje për teqenë e Frashërit dhe të tjera që ushtrojnë funksionin e tyre në kufijtë administrativ të Bashkisë Përmet, sidomos në forcimin



e bashkëpunimit me klerikët dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Sipas saj, në këtë kuadër, për përmirësimin e rrugës së Frashërit, do të kërkohen mundësitë për sjelljen e saj në parametra të pranueshëm, mundësisht në një kohë sa më të shkurtër.

Në vazhdim, besimtarë e të pranishëm të tjerë, shijuan ashuren e përgatitur me këtë rast dhe vazhduan gjatë këngët e nefeset bektashiane, duke e bërë më të hijshme këtë ditë të shënuar.



Shkrepëtima e ndritshme e Tij



Fundshtatori në Korçë, vjen përmes aromës së mollëve dhe butësisë së erërave që mbështjellin qytetin për t'u larguar më pas në gjoks të Moravës. Kujdesi me të cilin vjeshta qëndis peizazhet, duket edhe këtu në teqenë e Turanit, në oborrin e bukur të sheshit, në gjelbërimin përpara tyrbeve që mbajnë brenda fletëza të arta nga historiku i bektashizmit. Të moshuar të fshatrave për rreth, që mbajnë të gjitha kujtimet e disa dekadave më parë, burra e gra që jetuan vitet e mënxyrëshme të ndalimit të besimit në Zot, të rinj të bankave të shkollës që u gëzohen ardhjeve të para në teqe, i ka mbledhur sot, përveç ashures, jubileu i ndritur i 90 vjetorit të Kongresit të Tretë Bektashian, i cili do të mbahet mend gjatë. Të dy ngjarjet madhore të kësaj dite, mbajnë distancën shekullore midis tyre, kanë në

thelb të tyre, kujdesin për të mbajtur të pastër shpirtin, vëmendjen e përjetshme ndaj Zotit dhe kombit.

E kam admiruar kurdoherë këtë gëzim të ditëve në teqe. Nga myhibët e vjetër, tek fëmijët e shkollave. E shoh sot gëzimin se si është ulur në bisedat e anëtarëve të orkestrës frymore të Korçës, ku përmes notave të himneve, shpirtrat marrin krahë si zogjtë. E shoh atë në sytë e besimtarëve që u drejtohen mezareve, me atë përlësi siç u janë drejtuar dikur gjysh-stërgjyshërit e tyre. Dhe nëpër mend më vijnë të famshmit rreshta të Mevlana Rumiut: "Në të vërtetë, puna e fesë nuk është gjë tjetër veç habitjes, mahnitjes dhe admirimit. Por ku admirim nuk është t'i kthesh shpinën kibles të së vërtetës për shkak se mendja nuk e arrinë plotësisht atë, përkundrazi, është të biesh në mahnitje si i dehur dhe i dalldisur



pas mikut! Sepse po ramë në gjumë, do të thotë se kemi rënë në dalldi me ashkun për Zotin, jemi bërë të dehurit e Tij. Po të jemi të zgjuar, përjetojmë sa e sa të fshehta në eposin e shkruar prej Tij... Kur qeshim, bëhemi shkrepitima e ndriçimit të Tij.”

Pak përpara ceremonialit të thjeshtë, vijnë në teqë edhe përfaqësues të feve e besimeve të qytetit, si dhe Kryetari i Bashkisë z. Sotiraq Filo. Është një traditë e mrekullueshme kjo, e ndarjes së gëzimit të festave. Sepse shekujt na kanë mësuar tanimë që të jemi të bashkuar si etni, si racë, si komb. Dhe nëse ky bashkim ecën gjithmonë drejt devocionit ndaj Krijuesit, atëherë brengat zvogëlohen dhe shumëfishohen shpresat. Se arritjet apo gëzimet e një komuniteti, janë gurë themeli në mbarësinë e një kombi. Ja çfarë deklaronte në kuvendin e tretë bektashian, baba Ali Tomorri: “Korça me ne dhe, ne me Korçën...ja fjala e dhënë midis këtyre dy elementëve të vlefshëm. Kongreset ortodoks dhe bektashi, të mbledhur në Korçë, realizuan qëllimet e tyre të shenjtë, për të mirën dhe forcimin e solidaritetit të kombit shqiptar. Mund të themi pa pikë dyshimi se këta dy kongrese, së bashku me atë të shqiptarëve syni që u mbledh në Tiranë, shënojnë një vepër tepër madhështore të realizuar dhe një shtyllë tjetër të fortë për bashkimin e kombit.” (Gazeta e Korçës, tetor 1929).

Ashtu si 90 vite më parë, ceremonialin e ka çelur orkestra frymore e qytetit të Korçës, me notat e himnit tonë kombëtar. Më pas, Kryegjyshi Botëror

Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj ka udhëhequr këndimin e lutjeve me rastin e ditës së ashures, duke risjellë në kujtesën e të gjithëve, ngjarjen e fundme të Qerbelasë, martirizimin e Imam Hysenit, paqja qoftë mbi të. Ndonëse kanë kaluar shekuj të tërë, ajo ngjarje ende sot, përcjell në zemra besimtarësh, mesazhin e qëndresës emblematike të moralit dhe nderit të panjollësor, kundrejt pushteteve të pamerituar, kundrejt gjërave të vdekshme të kësaj bote, që na rrethojnë ende sot me vezullime gjithfarësh. Ritet ceremoniale të ditës së ashures, mbyllen me një lutje për ditën e sotme.

Pastaj është sërish Kryegjyshi Botëror që duke falënderuar të pranishmit, thotë midis të tjerave:


“...26 shtatori i këtij viti, mbart brenda tij dy simbolika të shtrenjta. E para, lidhet me ditën e ashures, me përkujtimin e përvitshëm historik që i bëjmë betejës së Qerbelasë. Simbolika tjetër, na kujton se 90 vite më parë, këtu ku jemi mbledhur sot, tek ky vend i bekuar i teqesë së Turanit, është mbajtur Kongresi i III-të bektashian. Në respektin tonë të thellë ndaj këtyre dy ngjarjeve, bashkohen sigurisht besimtarë bektashianë nga e gjithë bota, kudo ku ata jetojnë me frymën e shenjtë të dervishëve dhe baballarëve. Është krejt e natyrshme, që në radhët e besimtarëve tanë pyesin” “Si nuk u harrua kjo betejë e Qerbelasë?”. Sepse është shumë e vërtetë që në universin e madh shiit, sikundër edhe komunitetet bektashianë të kudonodhur në botë, zija e matemit mbahet gjallë përmes



këndimit të Hadikasë dhe riteve të tjera zakonore, sikundër sillen ndërmend vepra e mrekullueshme e Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'të, dhe 72 dëshmorëve të tjerë të asaj beteje. Përgjigja e kësaj pyetje është shumë e thjeshtë. Imam Hyseni ishte i vetëdijshëm që do të flijohej. 72 dëshmorët e tjerë e dinin gjithashtu se në dyluftim me forcat e Mavijes, do të linin jetën e tyre. Por ata nuk mund të pranoin një Islam të mbështetur në luftë për pushtet të pamerituar. Ata nuk do të pranoin kurrë, që brenda familjes së madhe myslimane të zinin vend intrigat, meritë dhe poshtërsitë, qoftë edhe përmes marrjes së turpshme të kalifatit. Ata nuk mund të jetonin me etjen për gjak të një pushteti të paligjshëm, ku vetitë më të mira fetare dhe njerëzore përbalteshin me veset e djallit. ...Simbolika tjetër që na ka mbledhur sot, është padyshim 90 vjetori i Kongresit të tretë bektashian. I ideuar dhe përgatitur nga klerikë dhe intelektualë bektashianë të

tillë si: gjysh Kamber Prishta, gjysh Bektash Shëmbërdhenji, baba Mehmet Kruja, baba Ali Tomorri, si dhe atdhetari Xhevat Kallajxhi, ky kuvend do të gjente përkrahje nga shteti shqiptar i kohës, i bindur se ky besim meritonte respekt të veçantë qysh në lëvizjen autonomiste shqiptare. Përgatitja e këtij Kongresi, që nga perceptimi i realiteteve dhe deri tek mesazhet që do të përcillte, u vlerësua në kontekstin e lidhjeve tona jo vetëm me bektashinjtë e Turqisë, por edhe me ata të Egjiptit, Irakut, Sirisë dhe sidomos të Ballkanit. I çelur në mënyrë solemne, më 26 shtator, kuvendi i tretë bektashian, padyshim do të ishte në udhën e dy të parëve, atij të Prishtës më 1921 dhe të Gjirokastrës më 1924. Ai do të sillte në vëmendje, jo thjesht veprimtarinë e mrekullueshme të bektashinjve në vitet 1921-1929, por edhe kontributin e spikatur të tarikatis tonë, i cili duke pasur në esencë të filozofisë së vet, mençurinë emblematike të Haxhi Bektash

“...26 shtatori i këtij viti, mbart brenda tij dy simbolika të shtrenjta. E para, lidhet me ditën e ashures, me përkujtimin e përvitshëm historik që i bëjmë betejës së Qerbelasë. Simbolika tjetër, na kujton se 90 vite më parë, këtu ku jemi mbledhur sot, tek ky vend i bekuar i teqesë së Turanit, është mbajtur Kongresi i III-të bektashian. Në respektin tonë të thellë ndaj këtyre dy ngjarjeve, bashkohen sigurisht besimtarë bektashianë nga e gjithë bota, kudo ku ata jetojnë me frymën e shenjtë të dervishëve dhe baballarëve. Është krejt e natyrshme, që në radhët e besimtarëve tanë pyesin”
“Si nuk u harrua kjo betejë e Qerbelasë?”. Sepse është shumë e vërtetë që në universin e madh shiit, sikundër edhe komunitetet bektashianë të kudondodhur në botë, zija e matemit mbahet gjallë përmes këndimit të Hadikasë dhe riteve të tjera zakonore, sikundër sillen ndërmend vepra e mrekullueshme e Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'të, dhe 72 dëshmorëve të tjerë të asaj beteje.



Veliut, ishte shndërruar në një faktor të dukshëm të harmonisë ndërfaqetare në Shqipëri. Aty u sollën shembuj të veprimit e mendimit kombëtar, të inkurajuar prej klerikëve bektashinj, teqetë e të cilëve ishin vatra të mendimit të lirë, të mësimin të gjuhës shqipe, të forcimit të ndjenjave atdhetare, kundër rreziqeve të panumërt që na vinin prej fqinjëve tanë ballkanik. Kuvendi i tretë bektashian, në legjitimitet të plotë të tij, institucionalizoi dhe i dha impuls të ri, organizimit të bektashinjve përmes një statuti, që i parapriu pavarësisë së plotë të komunitetit shqiptar dhe i rrugës së ardhjes në Tiranë të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane... Mëvetësia e shpallur në këtë kuvend, u dha bektashinjtë të gjithë trevave të Shqipërisë frymëzimin për të ecur pa u ndalur në rrugën e Zotit dhe prosperitetit të kombit. Kjo mendësi nuk do të kalonte aq lehtë po të kemi parasysh jo vetëm rrymat fetare në Turqi, por edhe ithtarët e tyre këtu, të cilët u ngritën hapur dhe në kundërshtime të forta. Por mbarë opinioni publik përkrahën zhvillimet tona, të bindur se në të ardhmen ne do të ishim sërish në përkrahje të ndjenjave kombëtare... 15 vite më parë, ne u mbledhëm në këtë teqe të bekuar dhe festuam 75 vjetorin e kongresit të tretë bektashian. Kush ka qenë asaj kohe këtu, mbanë mend midis të tjerave edhe fjalën e urtë të myrshidit tonë, dede Reshat Bardhi, i cili duke folur për plejadën e baballarëve që bënë kongresin, tha se emrat e tyre do të ndriqnë kurdoherë në rrugën e gjatë të bektashizmit botëror. Personalisht e quaj veten me fat që dede Reshati ma besoi mua misionin e madh të ringritjes së besimit bektashian në këtë trevë, në ringritjen e teqesë së Turanit, të Kreshovës, të Qesarakës, Inonishtit si dhe të disa teqeve të tjera. Me ndihmën e Zotit, me ndihmën e dedelerëve dhe baballarëve, me ndihmën tuaj të çmuar,

Kuvendi i tretë bektashian, në legjitimitet të plotë të tij, institucionalizoi dhe i dha impuls të ri, organizimit të bektashinjve përmes një statuti, që i parapriu pavarësisë së plotë të komunitetit shqiptar dhe i rrugës së ardhjes në Tiranë të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane... Mëvetësia e shpallur në këtë kuvend, u dha bektashinjtë të gjithë trevave të Shqipërisë frymëzimin për të ecur pa u ndalur në rrugën e Zotit dhe prosperitetit të kombit. Kjo mendësi nuk do të kalonte aq lehtë po të kemi parasysh jo vetëm rrymat fetare në Turqi, por edhe ithtarët e tyre këtu, të cilët u ngritën hapur dhe në kundërshtime të forta. Por mbarë opinioni publik përkrahën zhvillimet tona, të bindur se në të ardhmen ne do të ishim sërish në përkrahje të ndjenjave kombëtare... 15 vite më parë, ne u mbledhëm në këtë teqe të bekuar dhe festuam 75 vjetorin e kongresit të tretë bektashian. Kush ka qenë asaj kohe këtu, mbanë mend midis të tjerave edhe fjalën e urtë të myrshidit tonë, dede Reshat Bardhi, i cili duke folur për plejadën e baballarëve që bënë kongresin, tha se emrat e tyre do të ndriqnë kurdoherë në rrugën e gjatë të bektashizmit botëror.



dhe të thellë respektin për kombin, por edhe vëllazëri-në me njeri-tjetrin; ndërsa zj. Ledina Arjolli shtoi se mozaikut fetar të Korçës, teqeja e Turanit, i ka dhënë padyshim urtësi-në tradicionale të besimit të Haxhi Bektash Veliut. Më tej, Kryetari i Bashkisë z. Filo ka uruar Kryegjyshin Botëror dhe gjithë bektashinjtë për simbolikën e dy

mendoj se teqeja e sotme e Turanit, vendndodhja e dikurshme e Selisë tonë të Shenjtë, përcjell çdo ditë e më shumë mesazhe paqe dhe vëllazërimi, me po atë shkëlqim si 90 vite më parë.”

Ka përshëndetur paskëtaj myftiu i qytetit, z. Ledion Cikalleshi, i cili duke sjellë ndërmend trimërinë e imam Hasanit dhe imam Hysenit tha midis të tjerave: “Duke kaluar kaq shekuj nga ngjarja e Qerbelasë ku ranë dëshmorë të drejtit dhe të virtytshmit. Dhe çfarë treguan

këta shekuj? Emrat e Mavijes dhe të Jezidit përshpëriten ende sot me neveri e urrejtje prej të gjithë myslimanëve. Përkundër kësaj, emrat e Hasanit dhe të Hysenit u përcollën nga brezi në brez me respektin më të thellë, ndaj mbetën edhe sot emrat më të preferuar të fëmijëve tanë që lindin.”

Përfaqësuesi i kishës ortodokse, Papa Andrea, bashkë me urimin për dy datat e shënuara bektashiane, përcolli idenë se harmonia fetare në Shqipëri, e ka bërë akoma më të vyer

datave, duke shtuar se në themel të këtyre gëzimeve, janë padyshim edhe përkushtimi dhe përpjekjet e klerikëve, të cilët mbajnë gjallë në popull, shpresat dhe dëshirat për ditë më ët mira.

Bisedat në oborrin e teqesë, vijuan më pas me një koktej, nën tingujt e orkestrës frymore. Notat e baladave të djeshme ndiheshin të gëzuara në atë mjedis lirik bektashian.

*Syrja Xhelaj
Turan-Korçë, shtator 2019*



Gjurmë drite në

E mrekuellueshme kjo ditë e 15 tetorit në teqenë e Koshtanit. Përballë rrënojave të hepuara nga pesha e viteve, shfaqen majat e Akrokeraunëve ndërsa më pranë nesh, janë malet e Kudhësit dhe Dhëmbanit. Poshtë në këmbët tona, Vjosa ecën e kaltër duke shpërndarë atë mërmërimën e lashtë sa vetë jeta e lumit. Këtij peizazhi i shtohen besimtarët bektashinj, ata të urtit, të ligështuarit prej brengave të jetës, të pafjalët, sepse në fund të fundit urtësia është substance jetësore e bektashizmit, e përcjellë nga brezi në brez, nga koha në kohë. Ata që e kanë në zemër teqenë dhe kujtimin e klerikëve të saj, ata që nuk mund ta lenë 15 tetorin t'u ikë pa ardhur në këtë vend të shenjtë, vijnë sot këtu me një barrë kujtimesh, me miqtë dhe familjet e tyre. I kanë ndarë së bashku në vitet e shkuar, ditët kur teqeja u harrua, ndaj dhe duan të ndajnë sot së bashku gjallërinë e saj të paçmuar.

Lumturia i ka kaluar të shtatëdhjetat. Ajo është bijë e këtij fshati dhe ndërsa rrimë në kafeoxhakun e sotëm të teqesë, në prani të klerikëve dhe besimtarëve, rrëfen vitet kur teqeja u mbyll për t'u bërë shkollë. Kjo ka qenë klasa e shtatë, thotë ajo dhe me sytë nga kafeoxhaku vijon... Pavarësisht se teqeja u mbyll, qysh nuk dëgjuam njeri të shante dervishët dhe baballarët. Asnjë për be. Në shtëpi, jo e jo, se unë i kisha prindërit myhibë, por edhe në shkollë s'dëgjuam një fjalë të keqe për 'ta. Bile pati edhe mësues që kur bënim ndonjë orë mësim të botanikës, na çonin të pastronim para e prapa teqesë dhe sidomos rreth e qark tyrbeve të vjetra. Në të vërtetë ne kujdeseshim për pemët dhe lulet, por na vinte mirë se kështu u shërbenim dhe mezareve të baballarëve. Më vonë, mësuam se kjo teqe, kishte çelur në konakët e parë shkollën shqipe në Tepelenë dhe na vinte mirë që ne ecnim në gjurmë drite. Edhe një gjë nuk më harrohet. Një muhabetet apo davetet që bëheshin në Koshtan, asnjëherë nuk mbeti pa



Koshtan

kënduar kënga e baba Ahmet Mavrovës. E deshën atë koshatnakët dhe tepelenasit, se desh dritën e diturisë edhe ai baba.

Të tjerë besimtarë u gëzohen këngëve dhe valleve të trevës së jugut. Në atë shesh aq të bukur në gjoks të maleve, ata kanë kryer ritet bektashiane pranë mezareve të tyrbeve, për t'u bashkuar në vallet labe. Përmes këtij gëzimi, i palodhuri i punëve të teqesë, Et'hem Resuli, së bashku me myhibin tjetër Skënder Hysi, nuk mund të mos kujtojnë në këtë ditë 15 tetorin e vitit 1998. Ata rrëfejnë se kanë qenë 10 burra nga fshatrat për rreth, që kërkonin rikthimin e lavdisë së shkuar të teqesë së Koshtanit. Jo për tu mburrur me historinë, aspak. Por për të shpërndarë atë dritë të dashurisë për Zotin, për të hapur shpirtrat e besimtarëve se po mbylleshin dita-ditës nga lakmia e pasurisë, nga marrëzia për t'u gdhirë zengjin. Ikën njerëzit nga sytë-këmbët, çanë detet e malet, morën udhët e kurbetit. Po bjerrej toka dhe

Tanimë, data 15 e çdo tetori, vjen plot mirësi e kujtime jo thjeshtë për banorët e Koshtanit, por të gjithë kësaj treve. Kjo datë ka mbetur e skalitur thjeshtë jo vetëm në historinë e bektashizmit në Shqipëri, por dhe në kalendarin e vyer të mendimit dhe veprimit tonë kombëtar. Me çeljen e shkollës së parë shqipë në këtë trevë nga baba Ahmeti, në vitin e largët 1908, oborri i kësaj teqeje që na ka mbledhur sot, u mbush me djem të ardhur nga Tepelena, Lumi i Vlorës, Mallakstra dhe deri Përmeti.

Duke u ulur në bankat e thjeshta të bëra me dorë nga dervishët e teqesë, ata djem do të mësonin gjuhën dhe librat shqip, duke mbushur në të ardhmen, radhët e çetave për liri të Shqipërisë. Lajmi për çeljen e kësaj shkolle nga baballarët e teqesë, do të shpërndahej jo vetëm në jugun e Shqipërisë por edhe më gjerë. Gazeta "Liria" që dilte në Selanik prej të urtit dhe të diturit Mid'hat Frashëri, do të shkruante veç të tjerave se "teqetë bektashiane po kthehen në vatra të ndjenjave më të lulëzuara kombëtare".

shtëpitë e Koshtanit. Ishte bjerrë besimi në dekada më parë.

Të dhjetë burrat shkuan në marsin e vitit 1998 në Tiranë në Selinë e Shenjtë Bektashiane dhe takuan dede Reshat Bardhin. I qanë hallin. Donin një klerik të rrinte në teqe ditë e natë. Të çelej dera e Hakut dhe të mos mbyllej më kurrë. Dedei i pat dëgjuar me vëmendje dhe i kishte mbajtur për drekë. Aty gjatë drekës, në muhabet e sipër, ai u kishte qarë hallin e teqeve, po këto duheshin mbështetur. Sepse edhe në kohërat më parë, përpara se të shkonte një dervish apo baba në teqe, mendohej





mirë: ku do mbështetej ai? Prandaj duhen myhib, e kishte përfunduar dede Reshati dhe u kishte dhënë porosinë e duhura për ata që duan të futen në rrugën e Haxhi Bektash Veliut, duke u premtuar se në natën e 14 tetorit të atij moti, do të çelte mejdanin e teqesë së Koshtanit për të pranuar myhibë.

Ah, or ah, psherëtin Skënder Hysi. Ngado dritë kish atë natë teqeja. Bënte dritë dede Reshati ngado që shkonte. Ne të dhjetët që kishim shkuar në Tiranë, ishim bashkë. Kur na pa, i ndriti nuri. E kuptoi se ne e kemi dhënë besën një herë e përgjithmonë. Nga marsi deri në tetor, ne folëm edhe me baba Haxhiun dhe ai na tregoi sekretet e myhibit. E ndamë hesapin dhe u futëm në mejdan. Ah, or, ah! Çfarë të dëgjoje nga goja e dedeit. Unë vetë u mbusha me lot dhe kur na bekoi të gjithëve në këtë udhë që do njeriu Zotin, do vëllanë e Hakut siç do vëllanë me nënë e me babë, do prindërit e tij, do familjen dhe gjithë vëllazërinë. Edhe dede Mondit, ja, në gjurmë të tij po ecën, na do dhe na dëgjon të gjithëve.”

Ceremoninë modeste e ka çelur baba Avdyll Shehaj, i cili ka falënderuar të gjithë të pranishmit, Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, si dhe pushtetarët vendor. Ai tha

Besoje se brezat do të kujtojnë me respektin e duhur klerikët bektashianë. Ndërkaq, nuk duhet të harrojmë se, si shtëpi e Haxhi Bektash Veliut, teqeja e bekuar që na ka mbledhur sot, ka luajtur një rol të spikatur edhe në kuptimin e devocionit ndaj Krijuesit, të shpërndarjes së urtësisë dhe dashurisë hyjnore. Teqeja e Koshtanit, pa dyshim që ka qenë e mbetet një shkollë, ku breza të tërë besimtarësh duke u edukuar me urtësinë dhe dashurinë e dervishëve dhe baballarëve tanë, e pranuan me shpirt vëllazërinë e mejdanit, e pranuan përlësinë ndaj më të mëdhenjve në moshë, pranuan kurdoherë këshillat e prindërve, jetuan me merakun për shenjtërinë e familjes shpirtërore dhe asaj biologjike. Pas emrave të shquar të Sadik Babait të ardhur nga viset e Thesalisë të dikurshme, si dhe të baba Ahmet Koshtanit, të dëgjuar për ndjenjat e shquara kombëtare, në historinë e kësaj teqeje do të mbetet i paharruar edhe emri i baba Shefqet Koshtanit.

se 15 tetori përbën gëzim për të gjithë bektashinjtë e Tepelenës dhe përcolli mesazhin që dera e kësaj teqeje do të mbetet kurdoherë e çelur.

Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian tha midis të tjerave:”... Tanimë, data 15 e çdo tetori, vjen plot mirësi e kujtime jo thjeshtë për banorët e Koshtanit, por të gjithë kësaj treve. Kjo datë ka mbetur e skalitur thjeshtë jo vetëm në historinë e bektashizmit në Shqipëri, por dhe në kalendarin e vyer të mendimit dhe veprimit tonë kombëtar. Me çeljen e shkollës së parë shqipe në këtë trevë nga baba Ahmeti, në vitin e largët 1908, oborri i kësaj teqeje që na ka mbledhur sot, u mbush me djem të ardhur nga Tepelena, Lumi i Vlorës, Mallakastër dhe deri Përmeti. Duke u ulur në bankat e thjeshta të bëra me dorë nga dervishët e teqesë, ata djem do të mësonin gjuhën dhe librat shqip, duke mbushur në të ardhmen, radhët e çetave për liri të Shqipërisë. Lajmi për çeljen e kësaj shkolle nga baballarët e teqesë, do të shpërndahej jo vetëm në jugun e Shqipërisë por edhe më gjerë. Gazeta “Liria” që dilte në Selanik prej të urtit dhe të diturit Mid’hat Frashëri, do të shkruante veç të tjerave se “te-

qetë bektashiane po kthehen në vatra të ndjenjave më të lulëzuara kombëtare”. Është fakt i njohur tanimë që shkolla e Koshtanit, qëndroi e tillë për vite me radhë, me kontributin e vetëm të baballarëve dhe dervishëve të teqesë. Për këtë akt kaq madhor në historinë tonë, besoj se brezat do të kujtojnë me respektin e duhur klerikët bektashianë. Ndërkaq, nuk duhet të harrojmë se, si shtëpi e Haxhi Bektash Veliut, teqeja e bekuar që na ka mbledhur sot, ka luajtur një rol të spikatur edhe në kuptimin e devocionit ndaj Krijuesit, të shpërndarjes së urtësisë dhe dashurisë hyjnore. Teqeja e Koshtanit, pa dyshim që ka qenë e mbetet një shkollë, ku breza të tërë besimtarësh duke u edukuar me urtësinë dhe dashurinë e dervishëve dhe baballarëve tanë, e pranuan me shpirt vëllazërinë e mejdanit, e pranuan përulësinë ndaj më të mëdhenjve në moshë, pranuan kurdoherë këshillat e prindërve, jetuan me merakun për shenjtërinë e familjes shpirtërore dhe asaj biologjike. Pas emrave të shquar të Sadik Babait të ardhur nga viset e Thesalisë të dikurshme, si dhe të baba Ahmet Koshtanit, të dëgjuar për ndjenjat e shquara kombëtare, në historinë e kësaj teqeje do të mbetet i paharruar edhe emri i baba Shefqet Koshtanit. Ky klerik mundi jo vetëm të mbajë në këmbë teqenë e shkatërruar prej andartëve grekë, por i ktheu asaj lavdinë e shkuar, duke e rritur e zgjeruar sidomos me dashamirës e myhibanë, të cilët përcillnin në vatrën e tyre atdhedashurinë nëpërmjet besimit. Hakmarrja ndaj tij në vitin 1948, në të vërtetë ishte hakmarrja e diktaturës ndaj besimit në Zot. Sistemi i

diktaturave kërkon gjithmonë të rivalizojë dhe anatemoj Krijuesin, sepse diktatorët jo rrallë e shohin veten disa qiej më lart. Por ky absurditet aq qesharak nuk do të vazhdonte më shumë se katër dekada, për t’ia lënë vendin lirive universale njerëzore. Në kuptimin e një dëshmorit bektashian, jeta dhe vepra e baba Shefqet Koshtanit, do të respektohet jetë e mot.

Në vitet që po jetojmë, natyrisht lirinë e besimit e kemi fituar një herë e përgjithmonë. Falë vullnetit të Zotit, ne sot mund të mbushim oborret dhe odat e teqeve, jo thjeshtë për të kujtuar histori, por të mbushemi me dëshira dhe shpresa. Ne klerikët bektashianë jemi realist se vendi ynë, Shqipëria e sotme, ka një mijë halle e brenge për të zgjidhur, ka udhëkryqe që nuk dimë se si do t’i kapërcejmë. Por ne jemi besimplotë se sa më shumë t’u drejtohem shtëpive të Zotit, sa më shumë të duam njeri-tjetrin, prindërit apo fëmijët, aq më lehtësisht mund t’i kalojmë barrierat e vështira të këtyre ditëve. Prandaj, ditë të tilla pelegrinazhi marrin kuptim të vërtetë dhe emocion të veçantë. Prandaj na mbushet zemra plot kur na takoni dhe ju takojmë...”

Përsëritetën paskëtaj edhe Kryetari i Bashkisë së Memaliajt z. Gjolekë Guci dhe ai i Tepelenës, z. Tërmet Peçi. Ata nënvizuan idetë se mirësitë dhe urtësitë e shpërndara nga kjo teqe në breza, kërkojnë një reflektim më të thellë prej të gjithëve, për të mbajtur në shpirtat e njerëzve së bashku me dashurinë e Zotit edhe atë të atdheut, të familjes, për të thirrur shpresën në çdo kohë.

*Syrja Xhelaj
Koshtan, 15 tetor 2019*



PRESIDENTI I REPUBLIKËS, SHKËLQESIA E TIJ, ILIR META, MER

FESTAT FETARE SI I



Në Sari-Salltik, njeriu ndjenë në çdo moment afërsinë me unitetin hyjnor. Ndoshta nga lartësia gjeografike. Ndoshta nga ajo pamje magjepëse që hapet me blerimin e butë të kodrave, për tu bashkuar me të kaltrën e Adriatikut. Ndoshta nga rrënojat e teqesë së dikurshme bektashiane, të frymëzuar sigurisht prej mendimeve të nxënësit shpirtëror të Ahmet Jeseviut. Sari-Salltiku tanimë është përjetësuar në mijëra tregime. Një sagë shekullore, që sa vjen dhe kërkon të dalë nga mjegullat e kohëve, diku në memorien e saj ruan edhe

këtë mekam të bekuar në malin e Krujës, vendin ku besimtarët bektashianë kanë ardhur plot nderim e respekt brez pas brezi.

Ka plot kujtime grishëse nga udhëtarë të ndryshëm, të njohur për erudicionin e tyre, që flasin për venprehjet e Sari Salltikut. Por unë do të veçoja atë të Evlija Çelebiut, aq shumë i përmendur dhe i cituar në historinë osmane dhe atë ballkanase. Duke iu referuar tyrbes së tij në Babadag, Evlia Çelebiu përshkruan me respekt të thellë vizitën e tij në këtë vend. Atij i kanë bërë shumë përshtypje dedei dhe dervishët bektashinj,

R PJESË NË KREMTIMIN E DITËS SË ASHURES NË SARI-SALLTIK

MOMENT BASHKIMI

të cilët ishin plot dituri dhe urtësi. Në vendin e duhur, gjatë kësaj vizite, Çelebiu ka dëgjuar paskëtaj këngë dhe poezi për Sari Salltikun të dala nga shpirtrat e dervishëve bektashinj, sipas ritualit të caktuar. Dhe dikur, ndofta në fund të këtij ceremoniali, sipas vetë Çelebiut, dyqind dervishë, njëzëri kanë shqiptuar: "Esselamu aleqym, ja ehli sheriat, ehli tarikat, ehli hakikat dhe ehli marifet!"

Kanë ardhur në këtë ditë feste në malin e bekuar të Krujës dhjetëra besimtarë. Seicili prej tyre ka histori që lidhen jo thjeshtë me mekamin e Sari Salltikut, por edhe me veprën e dhjetëra dervishëve e baballarëve që kanë shërbyer në këtë teqe, dikur aq të famshme për gjithë shqiptarët. Besimtarët takohen me njeri-tjetrin, qajnë hallet, gëzohen për mirësitë e njeri-tjetrit. Sikundër trishtohen edhe për fatkeqësitë e ndryshme që mund të kenë pasur brenda familjes së madhe të Hakut. Në këto biseda nuk mungojnë asnjëherë edhe dede Ahmeti dhe dede Reshati, të cilët, në mënyrë të veçantë, pas vitit 1967, gjetën tek besimtarët krutanë dyer dhe zemra të hapura, duke vijuar në këtë mënyrë amanetin e Pir Haxhi Bektash Veliut.

Së bashku me besimtarët kanë ardhur klerikë, Kryegjyshi Botëror e më pas edhe Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij, Ilir Meta... Është Kryegjyshi që uron të pranishmit për respektin e tyre dhe ceremoniali nis me këndimin e tekstit përkatës. Vargjet e Qerbelasë, morali i sakrificës së Imam Hysenit së bashku me 72 dëshmorët e tjerë, por edhe guximi i pashoq i Abaz Aliut, mbujnë në vetvete jo thjeshtë elementë të historisë, por edhe të aktualitetit. Pas mbarimit të ceremonialit, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ju drejtohet të pranishmëve, duke ju thënë se ndër tragjeditë njerëzore, kjo e Qerbelasë do të mbahet mend gjatë. Sepse, ndonëse kanë kaluar 15 shekuj, sërish personazhet e saj të dashur për krejt botën myslimane, udhëheqin me moralin e tyre fetar dhe njerëzor. Sepse pas 15 shekujsh ende Mavija dhe Jezidi tregohen me gjuhën e urrejtjes dhe njerëzit u largohen veprave të tyre duke u bashkuar me devocionin ndaj Zotit, në vëllazërinë e përjetshme njerëzore. Në fund, Kryegjyshi Botëror Bektashian është shprehur se pavarësisht ditëve që po jetojmë, me besim e shpresë, sfidat sado të vështira do t'i kapërcejmë.

Ndërsa Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Ilir Meta, në fjalën e tij përshëndetëse tha: "...I nderuar Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Haxhi Baba Edmond Brahimaj. Të dashur besimtarë myslimanë shqiptarë. Të nderuar miq e të ftuar. Kam kënaqësinë e veçantë që jemi bashkë në



Kanë ardhur në këtë ditë feste në malin e bekuar të Krujës dhjetëra besimtarë. Seicili prej tyre ka histori që lidhen jo thjeshtë me mekamin e Sari Salltikut, por edhe me veprën e dhjetëra dervishëve e baballarëve që kanë shërbyer në këtë teqe, dikur aq të famshme për gjithë shqiptarët. Besimtarët takohen me njeri-tjetrin, qajnë hallet, gëzohen për mirësitë e njeri-tjetrit. Sikundër trishtohen edhe për fatkeqësitë e ndryshme që mund të kenë pasur brenda familjes së madhe të Hakut.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS, SHKËLQESIA E TIJ ILIR META, në fjalën e tij përshëndetëse tha:
"...Të dashur miq. Festat tona fetare janë përherë momente bashkimi dhe gëzimi për të gjithë. Ato na mundësojnë të shprehim nderimin dhe respektin ndaj Zotit, por edhe mesazhin e njohur shqiptar të dashurisë, harmonisë dhe mirëkuptimit mes feve. Festa e ashures është dita simbol e nderimit të martireve, e devocionit deri në sakrificën me sublime për të mirën e njerëzisë, harmonisë dhe paqes sociale. Ko ditë na kujton të gjithëve se shoqëria jonë dhe sidomos klasa drejtuese ka nevojë për më shumë patriotizëm, përkushtim, drejtësi, përgjegjësi, ngrohtësi shpirtërore e bujari për qytetarët. Ne duhet të ofrojmë ndaj njeri tjetrit më shumë mbrojtje mirëkuptim, shpresë dhe përkujdesje, por në radhë të parë këtë duhet ta tregojmë ndaj familjeve në nevojë, jetimëve, të moshuarve të braktisur si dhe individëve me aftësi të kufizuar.

Sari Salltek, në ditën e ashures për të nderuar kujtim e dëshmoreve të Qerbelasë dhe mesazhin e sakrificës së tyre në dobi të paqes, mirësisë dhe dashurisë. Urimi im në këtë festë shkon për besimtarët bektashianë, të dashurit dhe familjet e tyre si dhe gjithë shqiptarët!

Të dashur miq. Festat tona fetare janë përherë momente bashkimi dhe gëzimi për të gjithë.

Ato na mundësojnë të shprehim nderimin dhe respektin ndaj Zotit, por edhe mesazhin e njohur shqiptar të dashurisë, harmonisë dhe mirëkuptimit mes feve. Festa e ashures është dita simbol e nderimit të martireve, e devocionit deri në sakrificën me sublime për të mirën e njerëzisë, harmonisë dhe paqes sociale. Ko ditë na kujton të gjithëve se shoqëria jonë dhe sidomos klasa drejtuese ka nevojë për më shumë patriotizëm, përkushtim, drejtësi, përgjegjësi, ngrohtësi shpirtërore e bujari për qytetarët. Ne duhet të ofrojmë ndaj njeri tjetrit më shumë mbrojtje mirëkuptim, shpresë dhe përkujdesje, por në radhë të parë këtë duhet ta tregojmë ndaj familjeve në nevojë, jetimëve, të moshuarve të braktisur si dhe individëve me aftësi të kufizuar.

Të nderuar pjesëmarrës. Në kohën që po jetojmë, përtej politikës së ditës e ardhmja po bëhet gjithmonë edhe me e pa shpresë për shumicën e shqiptarëve. Para



syve tanë të pasurit po bëhen shumë të pasur dhe të varfrit po kalojnë në skamje. Klima e varfërisë, korrupsionit, papunësisë, pasigurisë, krimit, padrejtësisë, lakmisë, dhe thellimit të ndarjes klasore po e errëson perspektivë e rinisë shqiptare. Mijëra vëllezër dhe motra po largohen çdo ditë të braktisur nga politikat jo efektive në vendin amë. Në këtë situatë duhet për një çast të ndalemi dhe të reflektojmë thellë ndaj plagëve të shoqërisë dhe fenomeneve që na shqetësojnë. Kjo ditë e flijimit dhe sakrificës njerëzore na fton të flakim tej egon e sëmurë, lakminë dhe indiferencën dhe të marrim përgjegjësitë para atdheut, familjes, shoqërisë dhe kombit. Perëndia le të na ndihmojë të gjejmë rrugën e duhur, për të nxjerrë në pah bashkësinë e vlerave tona më të mira atdhetare, etike, morale, njerëzore dhe hyjnore.

Të nderuar Miq! Shqiptarët kanë arsye për të qenë krenarë me historinë e tyre, moralin dhe vlerat njerëzore që mbartin. Në udhëtimin drejt Evropës ne kemi bërë përpjekje të jashtëzakonshme dhe kemi arritur të cilat nuk mund të lejojmë të errësohen nga zhvillimet e fundit politike, ekonomike e sociale. Në këtë mënyrë me besimin tek Zoti dhe dashurinë për vendin le të shtrimë dorën bashkëpunimit njeri tjetrit dhe të përkushtohemi edhe me shumë familjes, shoqërisë dhe atdheut tonë të dashur. Në përfundim do të desha t'ju siguroj për mbështetjen time në punën, përpjekjet dhe lutjet e tuaja për të mirën e qytetarëve dhe të ardhmen tonë të përbashkët. Gëzuar Ditën e Ashures! Lumturi e mbarësi për gjithë shqiptarët!"

Kuzum Baba në ditën e ashures



Madhështia e teqesë së lashtë së Kuzum Babait, nuk qëndron tek pozicioni gjeografik, nga ku për shkak të të cilit, e keVlorën e rrethinat në 'pëllëmbë të dorës', por tek historia e saj e lashtë shekullore, tek misioni i saj fisnik, si qendër e rëndësishme e besimtarëve bektashianë ndër breza dhe tek genia strehë dhe e mendimit e veprimit atdhetar shqiptar. Kështu ka qenë në kohët që shkuan, kështu do të mbetet. Përditë e më shumë, besimtarë vendas por dhe nga treva të tjera të vendit, vijnë këtu, me shpresën e qetësisë shpirtërore, ndihmën e Allahut për zgjidhjen e problemeve që kanë dhe me besim të palëkundur për udhën e Haxhi Bektash Veliut. Ndërsa dita e pelegrinazhit tradicional vjetor, dita e ashures, sigurisht shton ndjeshëm numrin e besimtarëve dhe gjeografinë e vendeve nga marrin udhë për



tek teqeja e Kuzum Babait. Kështu ka ndodhur dhe me pelegrinazhin e shtatorit të këtij viti.

...Teksa tingujt e nefeseve bektashiane e këngëve tradicionale labe e bëjnë më të paqtë e më të ndjeshme atmosferën e kësaj dite, grupe besimtarësh kryejnë ritet dhe diskutojnë me njeri-tjetrin. Për shumë prej tyre, kjo ditë është jo vetëm ditë shprese për të ardhmen, por dhe ditë ku gjejnë prehje shpirtërore e fizike. Në biseda e sipër, takojmë një 50 vjeçar, i cili na thotë se vjen shpesh këtu, pasi ka gjetur shërim. Na thotë se quhet Naim dhe vjen nga Lumi i Vlorës "...Kam vuajtur gjatë unë nga shëndeti, por këtu kam gjetur e gjej besim. Tri vjete rresht, më shumë rrija shtrirë, isha i këputur e i ligështuar. Erdha këtu, në një ditë pelegrinazhi si kjo dhe nisa përmirësimin. Vij vazhdimisht e përditë po bëhem më mirë. Jam më mirë shpirtërisht dhe fizikisht. Allahu na ndihmon ne besimtarëve bektashinj, shpresat tek ai i kemi. Pres të takoj Kryegjyshin Botëror..."-shton ai.

Kanë ardhur këtu në këtë event dhe Kryebashkiaku i Vlorës, Dritan Leli, funksionarë të tjerë lokal,

drejtues institucionesh dhe përfaqësues të besimeve të tjerë fetare. Kryegjyshi Botëror Bektashian i pret veçmas mysafirët, urojnë njeri tjetrin për festën, shijojnë së bashku ashuren dhe trajtojnë edhe probleme të tjera. Në ceremoninë e rastit, është Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj që drejton këndimin e lutjeve në nderim të ditës së ashures.

Ndërsa në fjalën e rastit, theksoi: "...Jam i lumtur sot që në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t'u përshëndes të gjithëve ju pjesëmarrës në këtë ditë të shënuar pelegrinazhi në teqenë e Kuzum Babait dhe t'u uroj mbarësi, dashuri e harmoni në familjet tuaja. Në veçanti dua të uroj besimtarët që kanë ardhur nga treva të tjera të vendit, nga Gjirokastra, nga Korça, nga Kruja, nga Dibra, nga Tetova, nga Prizreni e deri nga Gjermania e Holanda. Uroj e bekoj vëllezërit e mijë, klerikë bektashianë, përfaqësuesit e besimeve të tjerë fetarë këtu në Vlorë, Kryetarin e Bashkisë e drejtuesit e tjerë të institucioneve, të pranishëm sot këtu. Zoti u bekoftë! Sa herë që ne mblidhemi këtu, kujtojmë e respektojmë historinë e kësaj teqe

“

...Jam i lumtur sot që në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t'u përshëndes të gjithëve ju pjesëmarrës në këtë ditë të shënuar pelegrinazhi në teqenë e Kuzum Babait dhe t'u uroj mbarësi, dashuri e harmoni në familjet tuaja. Në veçanti dua të uroj besimtarët që kanë ardhur nga treva të tjera të vendit, nga Gjirokastra, nga Korça, nga Kruja, nga Dibra, nga Tetova, nga Prizreni e deri nga Gjermania e Holanda. Uroj e bekoj vëllezërit e mijë, klerikë bektashianë, përfaqësuesit e besimeve të tjerë fetarë këtu në Vlorë, Kryetarin e Bashkisë e drejtuesit e tjerë të institucioneve, të pranishëm sot këtu. Zoti u bekoftë! Sa herë që ne mblidhemi këtu, kujtojmë e respektojmë historinë e kësaj teqe të lashtë dhe brezin e klerikëve që kanë shërbyer këtu, që nga dita e çeljes së saj shekuj më parë, deri në ditët e sotme. Ata kanë bërë histori, duke lënë gjurmë në udhën e besimit tonë të shenjtë tetëshekullor. Kujtojmë sot Sejjid Ali Sulltan, emër i Kuzum Babait (Quzum Baba), që u lind në Teqenë e Madhe të Ohros dhe u rrit e u edukua me besimin bektashian, i cili pas viteve 1400, caktohet të kryej misionin e madh të besimit bektashian në Evropë dhe më pas në Shqipëri. Ky njeri i shenjtë nisat me bekimin se do të arrinte të bënte gjithçka për popullin në Vlorë dhe në trevat e tjera shqiptare për përhapjen e besimit bektashian.

“

të lashtë dhe brezin e klerikëve që kanë shërbyer këtu, që nga dita e çeljes së saj shekuj më parë, deri në ditët e sotme. Ata kanë bërë histori, duke lënë gjurmë në udhën e besimit tonë të shenjtë tetëshekullor. Kujtojmë sot Sejjid Ali Sulltan, emër i Kuzum Babait (Quzum Baba), që u lind në Teqenë e Madhe të Ohros dhe u rrit e u edukua me besimin

bektashian, i cili pas viteve 1400, caktohet të kryej misionin e madh të besimit bektashian në Evropë dhe më pas në Shqipëri. Ky njeri i shenjtë nisat me bekimin se do të arrinte të bënte gjithçka për popullin në Vlorë dhe në trevat e tjera shqiptare për përhapjen e besimit bektashian. Në këtë kodër këtu, pas ndarjes tragjike nga jeta të këtij kleriku, një grup besimtarësh të lagjes “Murabije”, e varrosin në ceremonitë e njuhura fetare. Në këtë kodër të bukur që shikon qytetin e Vlorës dhe detin u ngrit tyrbja e Kuzum Babait. Në vitet 1600 u ndërtua një teqe bektashiane, e cila pati shumë sukses dhe lulëzoi në veçanti, në shekullin e 17. Misionarët e sulltan Mahmudit II më 1826 e shkatërruan teqenë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore italianët e kanë përdorur si një repart të vogël ushtarak. Mbas vitit 1945 u restauruan ndërtesat dhe u ringrit tyrbja e Kuzum Babasë. U mbyll me ndalimin e fesë në vitin 1967. U rihap në vitin 1992. Në ngjitje të kodrës Kuzum Baba është vendosur busti i Dede Ahmetit (Kryegjysh Botëror 1950 - 1958), i cili mbas çlirimit të vendit ka bërë një punë të madhe në këtë teqe. Ajo ka zhvilluar aktivitetin e saj në çdo periudhë dhe sot është një nga qendrat më të rëndësishme për gjyshatën Bektashiane të Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë. Kjo teqe e madhe e ndërtuar mbi themelet e asaj të dikurshme, është bërë më e kompletuar për besimtarët tanë në rritje. Kur kujtojmë këtë histori, pjesë të udhës së begatë e të vështirë të besimit tonë bektashian, kemi të drejtën legjitime të mburremi e të ecim besimplotë në rrugën e ndritur të Haxhi Bektash Veliut, të bashkojmë besimtarët e të shtojmë radhët e këtij besimi, dashurinë e respektin për njeritjetrin. Veçanërisht, ky mision merr përparësi në këto kohë të vështira që po kalon vendi ynë. Gëzuar këtë ditë të bekuar! Zoti i bekoftë! Amin!”

Në përfundim, besimtarë, miq e të ftuar, kaluan një drekë të këndshme tradicionale bektashiane.

Koresp “Urtësia”



Poezi

Nga baba Meleq Shëmbërdhenji

Plaku im

Prej Muhamedit kish yllë
Dogji hërkën bëri pyllë,
Kush preu gurë posi dyllë
Plaku im Haxhi Bektashi.

Dëllinja e bëri vëndë
Dielli shiut ju bë tëndë,
Kush s'desh flori as argjentrë
Plaku im Haxhi Bektashi.

Vetë nënë shpëllë rrinte
I vinin miqt atje flinte,
Thanë s'passe fare dritë
Plaku im Haxhi Bektashi.

Miqt i zuri pakë gjumë
Kush hapi shkëmbin si brumë,
U mbush shpella dritë shumë
Plaku im Haxhi Bektashi.

Miqtë na gjumi u zgjuan
Hapnë sytë dhe shikuan,
Buzë e gishtë i kafshuan
Plaku im Haxhi Bektashi.

Çile hane mbet me emër
Pun gjëzën e ka në zemër,
Atje shkojnë burra - femër
Plaku im Haxhi Bektashi.

Meleq kush s'bën mir e bijë
I dashuri le ta dijë,
Kush la gurë për fëmijë
Plaku im Haxhi Bektashi.

Haxhi Bektashi

Tjatër s'kishim parë kurrë
Veç Haxhi Bektashnë pamë,
Kur bëri që foli gurë
U çuditnë an e mhanë.

Guri pa shpirt qysh ka folur
Frymë e Bektashit punonte,
Me shpirt pa shpirt kish të lodhur
Ay kudo thosh i shkonte.

Çpunëra që ka punuar
Nuk ta pret mëndja kurrë,
Tjetër rob s'i ka treguar
Po vetëmë ay burrë.

Ashtu vetën e tregojti
Që ish fisi Muhamedit,
Pa lagurë këmbët shkojti
Mi lumët si rëmbi detit

Gjindja këto kur i panë
I thanë ti qënke vetë,
E paske fis Mustafanë
Që të ndih Zoti Vërtetë.

Na ay fis që kish dalë
Ashtu duhej të tregonte,
Një shënim që kish në ballë
Muhamed Ali këndonte.

Del dielli ngre erësinë
Plaku im ashtu ka dalë,
E zgjoj gjithë njerëzinë
Me shkrimet që kish në ballë.

Nga imam Musa Qazimi
Është ndarë fis i tija,
Ka rrjedhur na Ali trimi
Ndaj e rriti Perëndia.

Gjysh kishte Muhamenë
Që stolisi këtë jetë,
Gjyshe kish Hadixhenë
Që stoli këtë jetë.

Nga fëmij e Fatimesë
Tek i gjashti është ndarë,
Ndaj e kam të madhe shpresë
Që s'më le kurrë të qarë.

Ky bilbili i Perëndisë
Vjen që rrotull trëndafilut,
I jep dritë njerëzisë
Po si manushaqja prillit.

Plaku im Haxhi Bektashi
Që jam në udhët të tija,
M'a ngjalli mëndjen m'a rriti
Njoha ç'është njerëzia.

Meleq do të duash plakun
Udhën e tij t'a mbash mirë,
Sikur të të derdhin gjakun
Mos e ftoh këtë dëshirë.

7 dyti plak

Në mëngjes thëret bilbili
Ngrihu vëllezër mos flini,
Burbuqet hap trëndafili
Mëngjes pa falur mos lini.

Sa i bukur del mëngjezi
Ikën nata bënet ditë,
Ballëmi dritën e ndezi
Që të shohim drejtësitë.

Meri udhën drejtësisë
Tu dojë Ballëm Sulltani,
Hiqni dorë ligësisë
Gjën e huaj mos hani.

Në të botës mos mer pjesë
Puno se të jep Perëndia,
Po të hash vetë me djerse
Ashtu të do bektashia.

I dyti plak, bektashisë
Është Ballëmi vërtetë,
Ajo drit e mirësisë
Ka shënim për gjithë jetën.

Shënimi nuk haronet
Sa të përmbysët kjo jetë,
Po më shumë i ndërtonet
E tregon udh e vërtetë.

Vuri themel bektashisë
Që nukë prishetë kurrë,
I afërt i Perëndisë
Ballëmi, vërtetë burrë.

I ndritë fytur e tija
Po si Jusuf Pejgamberit,
Ja kish dhënë Perëndia
Më ndihetë mua të mjerit

Ballëmin, Meleq lëvdove
Po shiko për vehten tënde,
Se fjalët i zbukurove
Mos shko në të kalbur vënde.

Mos largo

Po vure dëshirën e jetës
E drejta të mbet mënjane,
Mos ju largo të vërtetës
Po dëgjo Ballëm Sulltanë.

Ballëmi është një burrë
Tregon vetë pun e tija,
Se nukë i prishet kurrë
Lëshoj rrënjë mirësia.

I qëroj udhët mirësisë
E të ligat i dëbojti,
I dashuri i Perëndisë
Me Kuran vetëm punojti.

Kuranë e kish dëshirë
Në porosi ty s'ka gënjer,
Fjal e Zotit ëmbëlsirë
Me ajet na ka rrëfyer.

Urdhërim Zoti ç'ka bërë
Ato punë do punuar,
Ç'ka ndaluar që të tërë
As me sy s'duhet shikuar.

Kush e desh Ballëm Sulltanë
Porositë që la vetë,
Lumthit ata që t'i mbajnë
I do dhe Zoti vërtetë.

S'punojti jashtë Kuranit
Pa e deshi Perëndia,
S'i humbet emri Sulltanit
E përmëndin bektashia.

Po deshe t'a kuptosh mirë
Shiko gjej njeri të ditur,
Të mos jetë trumbullirë
Po të jetë i stërvitur.

S' marr dot vetëm diturinë
Po gjej një udhë rrëfenjës,
Të mos ketë lakminë
E të mos jetë gënjenjës.

Shikoje të jet i drejtë
E të mos jetë pas kërmës,
Ay t'a jep me të shpejtë
E të ndrit si hëna mbrëmës.

U ruajt të mos gënjenesh
Po njerinë e zgjith mirë,
Më çdo vënt të mos rrëmbenesh
Se të shpije në kalbësisë.

Gënjeshtari kurdoherë
Del si vaji për mi gjellë,
Ay po të heth në serë
Se me djallë është pjellë.

Meleq t'i mbash porositë
Ballëmit me të vërtetë,
Dhe nata të bënet dritë
Sheh këtu dhe n' atë jetë.

Jetën e lashë mënjane

I pashë pasqyrën e jetës
Unë të drejtën e mora,
I rashë pas së vërtetës
Me atë zë u përdora.

Gjeta Muhamed Alinë
E mora udhën e tyre,
Plak Haxhi Bektash Velinë
E më s'dua tjetër ngjyrë.

Jetën e lashë mënjane
Muhamed Alinë dua,
Po të gjithë që më panë
Le të qeshin me mua.

Kush më sheh dervish të mjerë
Thotë qënka i habitur,
Sa e gjeta këtë derë
Shumë kohë e kam lipur.

Një plak kërkova në jetë
E gjeta si desh Perëndia,
Më tha kjo udh e vërtetë
Del te Muhamet Alia.

Zhvillohet në Tiranë Samiti i Paqes për Ballkanin

Të bashkuar në sfida



Në datat 25-27 tetor 2019, u zhvillua në Tiranë Samiti i paqes për Ballkanin, nën patronazhin e kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama. I ideuar dhe zhvilluar si vazhdimësi e veprimtarive të tilla në shumë vende të botës, që përkrahin bashkëpunimin, mirëqenien e përbashkët si edhe vlerat universale të paqes, samiti në fjalë përfshiu udhëheqës të lartë të shteteve dhe fetarë nga e gjithë bota. Një grup i përzgjedhur i një niveli të lartë delegatësh, përfshi krerë aktualë dhe të mëparshëm

shtetesh dhe qeverish, parlamentarë, udhëheqës fetarë si dhe drejtues të shoqërive civile, trajtuan në fjalët e tyre çështje të shumta që lidhen jo thjeshtë me aktualitetin e sigurinë e sotme në Europën Juglindore, por edhe në kërkimin e zgjedhjeve drejt një paqeje të qëndrueshme në këtë rajon. Një këndvështrim realist përfshiu ndërkaq edhe sfidat e epokës së sotme, aq të mëdha, sidomos në Ballkan, të cilat mund të kalohen vetëm përmes nismave dhe programeve që mbështesin pajtimin dhe bashkëpunimin përtej kufijve tradicionalë të religjionit,

Zhvillohet në Tiranë Samiti i Paqes për Ballkanin

nt e epokës së sotme

racës, etnisë dhe kombësisë.

Në seancën plenare të ditës së parë të samitit, moderatori, zëvendës-president i Federatës së Paqes Universale, z. Nackues Marion, ftoi Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, të bënte lutjen e rastit për paqen në botë dhe eventin në

veçanti. Lutja u duartrokoi nga të pranishmit që mbushën sallën madhështore të Pallatit të Kongreseve. Më pas, në lutje po me fjalë zemre u këndua nga Dr. Marijan Orsolic i dioqezës Shën Polten të Austrisë, i cili gjithashtu, ishte tepër mbresëlënë. Paskëtaç sollën mendimet e tyre për shqetësimet e sotme në Ballkan, për

marrëdhënien e kombeve ballkanike midis tyre, për sfidat europiane: Elisa Spiropali në emër të Qeverisë së Shqipërisë, Stevo Pendarovski, President i Maqedonisë Veriore, Albin Kurti, deputet i Kosovës, Hashim Thaçi President i Kosovës, Alfred Moisiu ish-President i Shqipërisë dhe Dr. Hak Ja Han Mon, Udhëheqëse e



Federatës së Paqes Universale. Fjala e saj ishte tepër entuziaste dhe u duartrokoi gjatë nga pjesëmarrësit në samit. Në fund të këtij paneli, u lexua edhe një deklaratë e Këshillit të Europës.

Sesionin e tretë të mbajtur pasditen e datës 26 tetor, me moderator rabinin Kevin De-Carli nga Qendra e Studimeve Ndërfetare në Zvicër, e çeli Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili duke u ndalur në kontekstet fetarë në Ballkanin e trazuar tha midis të tjerave: “... Është kënaqësi e veçantë për mua të marr pjesë në këtë veprimtari kaq domethënëse dhe më lejoni t’u sjellë urimet e mia më të mira, si dhe përsëritjet e miliona besimtarëve bektashinj të kudonodhur në botë. Zoti i lartë qoftë i kënaqur me devocionin që rrëfeni dhe sjellte paqe e mirësi në familjet tuaja! Në vështrim të parë, arritjet e mëdha teknologjike, përparimet e shkencave marramendëse, zhvillimet molekulare që po transformojnë

idetë e deridjeshme, të mbështetura çdo hap prej globalizmit, duket se po e çojnë botën drejt mrekullive. Sigurisht të gjithë ne, kush më shumë e kush më pak, jemi subjekte të këtij transformimi dhe gjendemi shpesh përpara dilemave se nga cili krah të lëvizim, për t’iu përshtatur sa “më butë” modernitetit të epokës. Por edhe në këtë pozitë, jo rrallë të sikletshme, nuk është e vështirë të kuptosh se kur flitet për paqen dhe universalitetin e saj, sfidat janë të shumta dhe të prekshme. Këto, herë shuhen dhe zbuten, por asnjëherë nuk zhduken, por përkundrazi, bashkudhëtojnë me trendet bashkëkohore, duke kërcënuar jo rrallë njëra-tjetrën. Adresimi i sfidave nënkupton së pari njohjen, njohjen dhe perceptimin real të strukturës së tyre. Në këtë sens, roli i besimit është i paimagjineshëm. E nënvizoj këtë ide, sepse vlerat mirëfilli edukative, qofshin myslimane, të krishtera, hindu apo hebraike, siç janë përunjësia, mëshira dhe solidariteti (aq shumë të spikatura tek Muhamedi,

aleqym selam, Jezu Krishti, Davidi etj), sot po u nënshtrohen goditjeve sekulariste. Këto goditje vijnë nga të gjitha anët, duke manifestuar prirjet e shoqërive moderne dhe duke tronditur së brendshmi themelet e fesë. Ne vlen të nxjerrim në pah, shumë më çiltër se deri më sot, etikën e besimit në Zot, përmes nxitjeve sa më të pranueshme për epokën, si dhe rigjallërimit të dinamizmit, duke u kthyer krahët dogmave pa esencë fetare. Në këtë kuptim mendoj se duhet të rreshtohemi të gjithë, në të njëjtën barrikadë, duke respektuar dhe pranuar në gjirin tonë sidomos ato që mbahen “fe të pakicave”, sepse në fund të fundit, siç ndajmë qiellin dhe tokën, ndajmë edhe fatin e përbashkët të bashkuar në devocionin tonë ndaj Zotit. Brenda kësaj barrikade ne duhet të jemi më të ndjeshëm se deri më sot kundrejt kërcënimeve që i vijnë familjes, kësaj qelize solide që mban në këmbë të sotmen dhe të nesërmen e vetë shoqërisë. Njëherazi, kontributi ynë fetar duhet të spikatë në edukimin e





fëmijëve. Një vështrim nxitimthi në botën e tyre, një ballafaqim i shpejtë rreth librave dhe filmave me të cilët gatohen fëmijët e sotëm, na bindin ndërkaq se është e vështirë të vendosësh kufij të saktë midis makinerive dhe qenieve të reja njerëzore. E pra, edhe në këtë rast sfidat tona vlen të shihen jo thjeshtë një akt-konstatimi, por një veprim fetar; të mençur; të kthjellët dhe kurdoherë energjik..... Rrugët e adresimit të sfidave, por sigurisht edhe të kapërcimit të tyre, nuk do të mund të gjenden lehtë, pa një përgjegjësi adekuate të liderëve fetarë. Është në një masë të konsiderueshme në dorën tonë, që të risjellim traditat fetare duke u dhënë kuptimin dhe konotacionin e duhur në kohërat që po kalojmë, sikundër të frymëzojmë shpirtin e mbushur me besim, kundruall materializmit shekullor. Ne vlen të identifikojmë prirjet e sotme të shoqërive moderne, duke u kundërvënë atyre përmes tolerancës fetare, besimin dhe shpresën e unitetit hyjnor. Besoj se mozaikët kulturorë dhe identitarë, do të zbukurohen më shumë përmes rolit të liderëve fetarë. Tarikati bektashian, të cilit unë i përkas, qysh prej 800 vitesh e deri më sot, ka mundur

“
Të gjithë ne, kush më shumë e kush më pak, jemi subjekte të këtij transformimi dhe gjendemi shpesh përpara dilemave se nga cili krah të lëvizim, për t’iu përshtatur sa “më butë” modernitetit të epokës. Por edhe në këtë pozitë, jo rrallë të sikletshme, nuk është e vështirë të kuptosh se kur flitet për paqen dhe universalitetin e saj, sfidat janë të shumta dhe të prekshme. Këto, herë shuhen dhe zbuten, por asnjëherë nuk zhduken, por përkundrazi, bashkudhëtojnë me trendet bashkëkohore, duke kërcënuar jo rrallë njëra-tjetrën. Adresimi i sfidave nënkupton së pari njohjen, njohjen dhe perceptimin real të strukturës së tyre. Në këtë sens, roli i besimit është i paimagjinueshëm. E nënvizoj këtë ide, sepse vlerat mirëfilli edukative, qofshin myslimane, të krishtera, hindu apo hebraike, siç janë përunjësia, mëshira dhe solidariteti (aq shumë të spikatura tek Muhamedi, aleqym selam, Jezu Krishti, Davidi etj), sot po u nënshtrohen goditjeve sekullariste. Këto goditje vijnë nga të gjitha anët, duke manifestuar prirjet e shoqërive moderne dhe duke tronditur së brendshmi themelet e fesë. Ne vlen të nxjerrim në pah, shumë më çiltër se deri më sot, etikën e besimit në Zot, përmes nxitjeve sa më të pranueshme për epokën, si dhe rigjallërimit të dinamizmit, duke u kthyer krahët dogmave pa esencë fetare.

“
përmes filozofisë dhe dinamikës së tij, të ngrejë ura paqeje midis racave, kombeve dhe etnive në kohëra të ndryshme, në vende të ndryshëm. Besoj se vitaliteti ynë,



brenda familjes së madhe myslimane, përveç vullnetit të Zotit, është padyshim, bashkimi i brezave të besimtarëve anë e kënd botës, në vizionin e kthjellët të vëllazërisë fetare, i cili na ndihmon të ngrihemi mbi çdo sfidë. Ndërkaq, ju bëj me dije, se asnjë ndjenjë krenarie, nuk do të mundet të errësojë vështrimin dhe kontributin tonë për paqen botërore. Ju faleminderit të gjithëve! Zoti ju ndihmoftë!”

Më tej e morën fjalën personalitete të tjerë të lartë si: Bujar Spahiu Udhëheqës i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Sheik Mansour Dioof, lider i tarikatit Muradija i Senegalit, Asmaa Kuftaro lidere e forumit të grave në Emiratet e Bashkuara Arabe, Jakob Finci, Ambasador, lider i komunitetit hebre në Bosnje-Hercegovinë dhe Nikki Nardby Doçi, udhëheqës i fondacionit ndërkombëtar për leadership. Në diskutimet e tyre u trajtuan parimet morale universale dhe përshtatjen e tyre në situatat e sotme, fryma që nevojitet për tejkalimin e pengesave, por edhe formimin dhe forcimin e një rrjeti global të liderve, të cilët me përkushtimin e tyre i shërbejnë të sotmes dhe të nesërme së familjes njerëzore.

Pas përfundimit të diskutimeve, panelistët dëgjuan me vëmendje fjalët e të pranishmëve në sallë, si dhe u dhanë përgjigje pyetjeve të ndryshme. Pyetjes se cili është roli i liderve të Islamit përballë rrymave radikale apo drejttimeve të tjera brenda familjes myslimane, Kryegjyshi Botëror Bektashian ju përgjigj: “Së pari ne jemi të vëmendshëm se nga vijnë dhe ku duan të shkojnë këto rryma, të cilat për hir të së vërtetës, nuk kanë asgjë të përbashkët me Islamin. Më pas, në kontaktet tona ne përpqemi t’u shpjegojmë se ku ajnë shtrembëruar dog-

mat dhe ku janë bërë përpjekje për të humbur gjurmët e traditave, sepse tradita mbanë gjallë identitetin e çdo besimi. Sigurisht bisedat, takimet, konferencat, samitet si ky i sotmi, janë armët tona. Kur këto rryma vijojnë të përçajnë, kur ato gjoja në emër të Islamit marrin përsipër të diskreditojnë atë, atëherë ka organe dhe mekanizma të veçantë që merren. Ne nuk ngremë armë ndaj askujt. Ne do të vijojmë misionin tonë të bashkimit. E shihni dorën e gjithësecilit? Ka pesë gishta dhe janë shumë të ndryshëm nga njeri-tjetri. Veç e veç ata sigurisht nuk mund të bëjnë asgjë, por të gjithë bashkë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë mrekulli.

Më tej, Samiti i Paqes Universale, soli në vëmendje ët pranishmëve çështjen e migracionit të ballkanasve, bashkëpunimin ndërfaqës të komuniteteve, rolin e medias vizive dhe asaj të shkruar, ndjeshmërinë ndaj familjes së sotme si dhe perspektivat e mundshme të rajonit në kontekstet gjeostrategjike, ekonomike dhe kulturorë. Personalitete të shquara dhanë mendimet e tyre, duke u prirë nga gjetja e mundësive për një ndërveprim ballkanik në të mirë të popujve të gadishullit, i cili, siç thuhet rëndom ka qenë dhe mbetet një fuçi baroti. Me të drejtë, shumë nga folësit në këto seanca plenare u ndalën jo vetëm jo vetëm tek rritja e ndjenjave të solidaritetit dhe humanizmit njerëzor, por edhe tek rrugët për t’iu afruar sa më natyrshëm Krijuesit, duke luftuar tendencat bashkëkohore për mekanizimin e qenies njerëzore.

Festivali i bekimit të familjes do të bënte një përmblyllje domethënëse të Samitit, me pjesmarrje të gjeër dhe të larmishme. I konceptuar si një shfaqje e dashurisë së shenjët për familjen, festivali në të vërtetë përçoi idenë se krejt shoqëria njerëzore është një familje e madhe njerëzore që meriton respektin, dashurinë dhe ngrohtësinë e çdo pjesëtari, përmes dashurisë së përjetshme ndaj Krijuesit. Në respekt të përpjekjeve dhe sakrificave, të mundit dhe djersës, të vizionit të kthjellët për paqen në familjen e madhe njerëzore, ishte vetë liderja e Federatës Universale të Paqes, Dr. Hak Xha Han Mun, e cila në mbyllje të veprimtarisë, do të vlerësonte me çmime speciale disa personalitete të lartë, midis të cilëve edhe kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Nëna Mun, siç e bëri të qartë, vlerësoi tek leadershipi botëror bektashian, “aftësinë për të qenë në vijën e parë të atyre që jo vetëm e duan paqen, por edhe sakrifkohen për të.”

Koresp. “Urtësia”

Profeti Muhamed a.s, simbol i vlerave më të vyera

Nga Xhemal Balla

Profeti Muhamed u lind me 20 prill të vitit 570, u rrit jetim, pa prindër, pa vëllezër e motra, i pashkolluar, por Zoti i lartësuar pikërisht për këtë e zgjodhi si të dërguar te një popull arab që nuk kishte asnjë element zhvillimi e qytetërimi. Ai brehej përbrenda nga lufta midis fiseve. Zoti e kishte pajisur atë me vlerat e larta njerëzore, që për një periudhë njëzet vjecare arriti që ky popull të bëhej shembull udhëheqje për popujt e tjerë. Ai ndryshoi mënyrën e të menduarit, zakonet dhe sjelljet e tyre morale. Nga një komb që nuk kishte nxjerrë njerëz me vlerë kombëtare, prodhoi me mijra intelektualë, që u përhapën në të katërta anët e botës për të predikuar mësimet e fesë islame, të moralit e të qytetërimit. Me sjelljen e tij fisnike pushtoi zemrat e njerëzve, e me simpatinë ndaj tij, bëri miq edhe kundërshtarët e vet. Profeti Muhamed ndërtoi shtet dhe u bë një ligjvënës. Mjafton të marrim emigrimin e profetit a.s. në Medinë. Atë e gjeti pa ndonjë organizim shoqëror e politik, sepse mbretëronte rregullisht fisnor. Cdo fis kishte ligjet e veta. Mirëpo ai bëri ndryshime rrënjësore si në aspektin fetar, ashtu edhe organizativ të qytetit. Eliminoi rregullin fisnor dhe në vend të tij vendosi pushtetin islam. Kështu Medineja bëhet qytet-shtet i parë islam në histori. Organizoi jetën publike të bashkësisë duke i dhënë asaj funksionet juridike, educative, financiare, ushtarake dhe fetare.

I dërguari i Zotit, Muhamedi, paqja dhe bekimi i Tij qoftë mbi të, në përcjelljen e mesazhit hyjnor solli qytetërimin në vendet arabe, edukoi njerëz me dije e kulturë. Përhapja e vlerave si liria, barazia, e drejta ishin parimet themelore për të ndërtuar një shoqëri të civilizuar. Ai i plotësonte të gjitha kriteret për një udhëheqje të tillë, i frymëzuar nga Zoti i lartësuar.

Zoti e pajisi atë me një dituri e kultrë specifike, që diti të planifikojë, të bëjë politika paqësore, por edhe ushtri të fortë, të bëjë ekuilibre aty ku ishte nevoja, duke ruajtur parimet e së drejtës dhe të vërtetës. Këto vlera kanë qenë dhe mbeten aktuale për tu ndjekur edhe ditët e sotme.





Profeti Muhamed bëri reforma të tilla, që përmirësoi plagët më të rënda të shoqërisë arabe, si imoraliteti, alkooli, bixhozi, fajdeja, etj., të cilat janë prezent edhe sot në shoqërinë moderne, që po e gërryejn atë nga brenda. Ai shpalli pronën të shenjtë, nderin të shenjtë, barazinë gjinore të shenjtë, duke ngritur lart dinjitetin e femrës e deri te e drejta e saj për trashigimi. Ky ishte i zgjedhuri dhe i dërguari i Zotit, që për të parën herë bëri edhe kushtetutën mbi të drejtat e njeriut, por ai vetë provoi të jetonte si i varfër dhe si i pasur, si i dobët edhe i fuqishëm, si udhëheqës dhe njeri i thjeshtë, paqësor dhe luftëtar, por diti gjithmonë të krijonte lidhje të

shëndosha me të gjitha shtresat e shoqërisë njerëzore me popullin e thjeshtë vendas dhe të huaj dhe me fuqitë e mëdha perse e romake. Ai u shqua si diplomat në marrëveshje me fiset arabe, pa dallim feje, për të sjellë paqen e qetësinë në mes shteteve me të parin shtet islam. Nga ana tjetër lidhi ura komunikimi dhe me sundimtarët e shteteve të tjerë, por dhe me mbretër duke i ftuar në fenë islame. Në delegacionin që përcillnin mesazhin e tij dërgoi njerëzit me të aftë, të devotshëm e deri në jo muslimanë.

Profeti Muhamed kishte një aktivitet të gjerë politik. Nënshkrimi i paqes së Hudebijes, me konsensusin e lëshimit që bëri, arriti më

vonë fitoren më të madhe për muslimanët, që hynë fitimtarë në shtëpine e shenjtë në Mekë, Qaben e nderuar nga Zoti, që edhe sot vazhdon të jetë vend pelegrinazhi për gjithë muslimanët e botës. Ajo ishte aftësia diplomatike e Muhamedit me stafin e tij këshillues, që asnjëherë nuk e ndau në vendimmarrjet më të rëndësishme politike. Me këto arritje profeti Muhamed për 20 vjet u bë personaliteti më i madh i historisë së njerëimit. Kudo shihej madhështia e tij, si baskëshort, si prind, si gjysh, si njeri i thjeshtë e si udhëheqës. Këtë e shprehte dhe me shpirtin e tij që kur falej i lutej Zotit kështu: “Ndaj teje o Zot është ulur dhe përkushtuar dëgjimi im, shikimi

im, truri dhe nervat e mija”. Sa më shumë kontaktonte me njerëzit, aq më shumë shtoej dashuria për të, sa më shumë e shihnin njerëzit dhe jetonin me të, aq me shumë shtoej dashuria dhe respekti për të. Kështu zbuloheshin vlerat e tij të panumërta, që u bënë modeli për shoqërinë ku jetonte. Zoti në Kuran thotë: “E, dijeni se në mesin tuaj e keni të dërguarin e Allahut” (El Huxhrat, 7). Ky urdhër i Allahut të lartësuar përfshihet te të gjithë muslimanët, në cdo vend e në cdo kohë me thirrjen: “O besimtarë, dijeni se në cdo vend ku ndodhni dhe në cdo kohë që të jetoni; dijeni pra se keni të dërguarin e Zotit, jo fizikisht, por keni traditat e tij. E keni me moralet që la pas, e keni sepse ajo që la pas është një pasuri e shtrenjtë për të gjithë njerëzimin.

Le të kujtojmë gjendjen në të cilën ndodhej profeti Muhamed kur filloi të përhap mesazhin hyjnor. Ai e filloi nga zeroja, i vetëm në rrugën e tij të vështir. E, Zoti i tha: “E, ne të dërguam ty Muhamed vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat” (El Enbija 107). Me këtë urdhër hyjnor Muhamedi punoi 20 vite punë të planifikuar me lodhje e sakrifica. Tani ishte koha e planifikimit dhe derdhjes së djersës që me fjalët e para të shpalljes së profetësisë, “Lexo”, që do të thotë: “Tani me diturinë, planifikoni dhe përpiquni se Zoti është me ju dhe se mrekulli nuk do të ketë më. Mrekullia do të jesh ti o musliman që ndjek rrugën e Zotit. Mrekullia do të jenë gjithë ata burra e gra, që besojnë Zotin, që vendosin të përmirësojnë jetën në Tokë dhe jetojnë për të arritur qëllimin për të cilin u krijuan.

Një njeri i vetëm, i dërguari i Zotit, me cilësitë më të larta të

personalitetit të tij, dhuruar nga krijuesi, Muhamedi udhëhoqi botën islame, e solli qytetërimin në botën arabe me shkolla, universitete, biblioteka, etj., ku u edukuan njerëz me kulturë të lartë, të përkushtuar te besimi në Zotin Një, të drejtë në administratë e në shoqëri. Nga elita e këtyre njerëzve dolën misionarë, që u përhapën në të katërta anët e botës për të përcuar diturinë, moralin, për një shoqëri të qytetëruar. Drejtësia dhe sinqeriteti ishin vlera të personalitetit të të dërguarit të Allahut që e thërrisnin “El emini”, “i besueshmi”. Me këto parime u edukuan misionarët

e islamit, që përhapnin diturinë e kulturën. Vetë profeti Muhamed u kishte thënë: “Unë kam ardhur për të plotësuar e realizuar sjelljet më të mira tek njerëzit”. Mbi këtë bazë muslimanët filluan të ndërtonin jetën e tyre individuale, familiare e shoqërore, që krijuan dhe qytetërimin.

Profeti Muhamed me personalitetin e tij të lartë u bë shpëtimtar i qytetërimit në përcjelljen e mesazhit hyjnor, Kuranit famëlartë. Mbi këtë bazë nxorri ligjet që njerëzit duhet të jetojnë në paqe pa dallim rrace e gjinie përmes kombeve. Zoti është Një për të gjithë, kom-



Profeti Muhamed me personalitetin e tij të lartë u bë shpëtimtar i qytetërimit në përcjelljen e mesazhit hyjnor, Kuranit famëlartë. Mbi këtë bazë nxorri ligjet që njerëzit duhet të jetojnë në paqe pa dallim rrace e gjinie përmes kombeve. Zoti është Një për të gjithë, kombet dhe njerëzit janë anëtar të një familje të madhe me origjinë të përbashkët. Zoti urdhëron të duam njëri tjetrin, të respektojmë bindjet e ndërsjellta për të shmangur konfliktet e luftrat shkatërrimtare. Ai i solli njerëzimit fenë e vërtetë. Me parimet islame u bë transformimi moral, shpirtëror e material, jo vetëm të botës arabe por edhe më gjerë. Prandaj figura e tij do të mbetet shembull ndër shekuj, fjala e tij do të tingëlojë ëmbël, në përparimet e shkencës në të gjitha fushat, sepse në të gjejmë porositë e tij të vena në jetë. Sa më shumë të përparoi dituria aq më shumë do të zbulojë sekretet e krijuesit në Kuranin famëlartë.



bet dhe njerëzit janë anëtar të një familje të madhe me origjinë të përbashkët. Zoti urdhëron të duam njëri tjetrin, të respektojmë bindjet e ndërsjellta për të shmangur konfliktet e luftrat shkatërrimtare. Ai i solli njerëzimit fenë e vërtetë. Me parimet islame u bë transformimi moral, shpirtëror e material, jo vetëm të botës arabe por edhe më gjerë. Prandaj figura e tij do të mbetet shembull ndër shekuj, fjala e tij do të tingëlojë ëmbël, në përparimet e shkencës në të gjitha fushat, sepse në të gjejmë porosinë e tij të vena në jetë. Sa më shumë të përparoi dituria aq më shumë do të zbulojë sekretet e krijuesit në Kuranin famëlartë. Ai është dritë që nuk shuhet kurrë. Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, thotë: “Zoti e dërgoi Kuranin për profetin e nderuar, paqja e Allahut qoftë mbi të. Libër, i cili shkëlqen si një kandil i fortë që nuk shuhet kurrë. Ai është pishtar, të cilit flaka nuk i errësohet kurrë, ai është det, i cili thellësitë nuk i gjenden me lehtësi, ai është rrugë, në të cilën nuk humbet e nuk ngatërron askush. Ai është themel i fuqishëm, i cili nuk shkatërrohet kurrë, ai është ilaç dhe melhem për sëmundjet, ai është ndihmë për përkrahesit e tij dhe nuk i le kurrë miqtë e tij që të dështojnë. Ai është i drejtë, i pakundërshtueshëm. Kurani i madhërishtëm është qendra dhe xhevahiri i fesë islame. Ai është burimi i dijes dhe njohurisë, dhe deti i urtësisë dhe mcurisë, i cili furnizon me ujë kopshtijet e së drejtës dhe të drejtësisë, e ku lulëzon cdo gjë e mirë”.

Le ta ndjekim dhe vazhdojmë të përcjellim mesazhin e tij. Le të

“

Sa më shumë të përparoi dituria aq më shumë do të zbulojë sekretet e krijuesit në Kuranin famëlartë. Ai është dritë që nuk shuhet kurrë. Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, thotë: “Zoti e dërgoi Kuranin për profetin e nderuar, paqja e Allahut qoftë mbi të. Libër, i cili shkëlqen si një kandil i fortë që nuk shuhet kurrë.



punojmë për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës sonë. Në këto ditë përkujtimore të ditëlindjes së të dërguarit të Allahut për gjithë njerëzimin, Muhamedin, pret nderime te vecanta nga e gjithë bota islame. Dhe ne të pranishmit i dër-

gojmë nderime e premtime se do të ndjekim rrugën e islamit dhe si model gjithmonë do të kemi këtë profet të madh që Zoti e dërgoi meshirë për të gjitha botrat. Le të përfitojmë edhe ne nga mëshira e tij. Amin!

Etyd për mëshirën hyjnore



Nga Said Nursiu

Në rrjedhat e shekujve shumë filozofë të islamit pajtohen në idenë se, ajo që e bën këtë univers të pafund të gëzohet është, në mënyrë të vetëkuptueshme, mëshira hyjnore. Dhe ajo që i ndriçon këto qenie të errëta është, në mënyrë të qartë, mëshira hyjnore. Dhe ajo që i rrit dhe i edukon krijesat duke u përpjekur brenda këtyre nevojave të pafund, në mënyrë të vetëkuptueshme, është përsëri mëshira hyjnore. Dhe ajo që e bën të gjithë universin të kthehet drejt njeriut, siç kthehen të gjitha pjesët e pemës drejt frytit të saj, dhe që i shkakton universit ta shikojë atë dhe të shpejtojë për ta ndihmuar njeriun është, në mënyrë të qartë, mëshira hyjnore. Dhe ajo që e mbush dhe e ndriçon hapësirën e pafund dhe që e stolisi këtë botë të zbratur, në mënyrë të vetëkuptueshme, është mëshira hyjnore. Dhe ajo që e caktoi këtë njeri kalimtar për përjetësi, që e bëri atë marrësin e mesazhit hyjnor dhe të dashurin e Krijuesit të Vetëm të para e të pas përjetësisë, në mënyrë të vetëkuptueshme, është mëshira hyjnore.

... Ashtu siç shikojmë në fytyrën e tokës vulën e mëshirës dhe stampën e njësisë hyjnore, po ashtu në fytyrën e natyrës shpirtërore të njeriut ndodhet një stampë e mëshirës hyjnore e cila nuk është më e ulët se sa vula e madhe e mëshirës në fytyrën e universit.

Meqenëse mëshira hyjnore është një e vërtetë kaq e fuqishme, tërheqëse, e këndshme, mbështetëse dhe e dashur, atëherë thuaj: “ Bismil’lahi - Rramani Rrahim” kapu fort pas kësaj të vërtete dhe shpëtoje veten tende nga vetmia absolute dhe nga dhimbjet e nevojave të pafund. Dhe afrohu për tek fronin e sulltanit të përjetshëm të para dhe pas përjetësisë, dhe nëpërmjet dhembshurisë dhe ndërmjetësisë dhe rrezeve të mëshirës hyjnore, bëhu marrësi i mesazhit, miku dhe i dashuri i atij sulltani!

Po, në të vërtetë, të grumbullosh me urtësi rreth njeriut botët e qenieve në univers, dhe t’i bësh ato të shpejtojnë për t’ia plotësuar të gjitha nevojat e tij me

mirësi, njohje dhe fuqi.

Me siguri, një mëshirë e tillë si kjo kërkon prej teje falënderime të përgjithshme e të sinqerta, dhe një respekt të madh e të papërzier. Prandaj thuaj: “ Bismil’lahi - Rramani Rrahim”, e cila është interpretuesja dhe shprehja e atyre falënderimeve të sinqerta dhe e atij respekti të madh e të papërzier. Dhe bëje atë si mjet për të shkuar tek dera e asaj mëshire, dhe si ndërmjetësin tënd tek i gjithë mëshirshmi mëshirëplotë.

Po, në të vërtetë, ekzistenca dhe realiteti i mëshirës hyjnore është aq i qartë si dielli, sepse ashtu siç ndodh thurja e një pëlhure të bukur në qendër nga vendosja harmonike e indit dhe endëses bazë dhe nga rregulli dhe pozicionet e fijeve që shtrihen drejt qendrës nga çdo drejtim, po ashtu fijet dritëdhënëse që shtrihen nga shfaqja e njëmijë e një emrave hyjnorë në sferën e gjerë të universit, endin një qëndisje të tillë dhembshurie në fytyrën e universit dhe një stampë mirëbërësi brenda një vule mëshire, e cila e shfaq vetveten për mendjet në mënyrë më të ndritshme se sa dielli.

Po, Ai i cili organizon diellin hënën, elementet, mineralet, bimët dhe kafshët dhe i vendos ato të gjitha në harmoni me rrezet e njëmijë e një emrave, si të ishin indet dhe endësja bazë dhe fijet e saj dritëdhënëse. dhe i nënshtron ato të gjitha në shërbimin e jetës; dhe Ai i cili shfaq mëshirën dhe dhembshurinë e Tij për krijesat duke vendosur tek të gjitha nënat prej bimëve dhe kafshëve atë mëshirë e dhembshuri të ëmbël e sakrifikuese ndaj të vegjëlve të tyre; dhe Ai i cili ia nënshtron gjallesat jetës njerëzore; nga kjo demonstroi rëndësinë e njeriut dhe treguesit më të ndritshëm të mëshirës së Tij dhe skalitjet më të bukura e të ëmbla të hyjnisë, dhe e ka bërë këtë mëshirën e Tij të gjerë si ndërmjetësuese të pranueshme e të njohur tek pasuria e Tij absolute nëpërmjet së cilës kërkojnë ndërmjetësinë gjallesat dhe njeriu, i cili ndjen nevojën më të madhe për atë mëshirë.

Në qoftë se je njeri i vërtet, thuaj “ Bismil’lahi - Rramani Rrahim” që kjo të jetë

ndërmjetësuese për ty. Sigurisht është e qartë dhe e vetëkuptueshme se është mëshira hyjnore ajo e cila pa harruar e pa ngatërruar asnjërin prej tyre, i ngre, i ushqen. i edukon dhe i administron katërqind mijë llojet e ndryshme të bimëve dhe kafshëve në tokë, pikërisht në kohën e duhur, me rregull perfekt, me urtësi e mirëbërësi, saqë me këtë administrim e zhvillim ka vendosur shenjat dhe vulën e njësisë hyjnore në faqen e globit tokësor. Dhe ashtu si ekzistenca e mëshirës hyjnore që është aq e sigurt sa ekzistenca e krijesave në faqen e tokës, po ashtu krijesat formojnë aq shumë dëshmi për realitetin e asaj mëshire, sa vetë numri i tyre.

Po, ashtu siç shikojmë në fytyrën e tokës vulën e mëshirës dhe stampën e njësisë hyjnore, po ashtu në

ngjall perfekt e mirëbërës. Në mënyrë të përbashkët, njëra nga dy situatat. Ose secili lloj nga llojet e krijesave e njej njeriun e i bindet atij dhe shpejton për ta ndihmuar atë, gjë e cila ashtu siç është krejtësisht e paarsyeshme, dhe gjithashtu e pamundur në shumë aspekte, ose një qenie absolutisht e pafuqishme si njeriu të kishte forcën e sovranit më të fuqishëm absolut, ose kjo ndihmë ndodh përmes njohurisë së Një të Gjithëfuqishmi absolut prapa perdes së universit. Domethënë, qeniet e ndryshme në univers nuk e njohin njeriun, por ato janë dëshmi e tregues për Atë që e njej këtë njeri, që e mëshiron dhe që e di gjendjen e tij, Ai është Krijuesi mëshirëplotë.

Eja në vete. A do të ishte e mundur që mos të njihje e mos të shikonte ty Krijuesi i Gjithë lavdishëm i Cili bën që të gjitha llojet e krijesave të kthehen drejt teje, dhe të shtrijnë duart që të të ndihmojnë dhe që i bën ato të thonë: Urdhëro, ja ku jemi!, përballë nevojave të tua; a do të ishte e mundur që Ai mos të të njohë ty, të mos njihet me ty dhe mos të të shohë ty? Meqenëse të njej ty, Ai të njofton se të njej përmes mëshirës së Tij. Atëherë edhe ti njihje Atë gjithashtu, dhe përpiku ta njohësh Atë duke respektuar urdhrat e Tij, dhe kupto me siguri se ajo që nënshtron universin e gjerë ndaj teje dhe që e bën universin të të ndihmojë ty, megjithëse ti je një krijesë absolutisht e varfër, e dobët, e vogël, e pafuqishme, dhe kalimtare, është e vërteta e mëshirës hyjnore e cila përmban urtësi,

fytyrën e natyrës shpirtërore të njeriut ndodhet një stampë e mëshirës hyjnore e cila nuk është më e ulët se sa vula e madhe e mëshirës në fytyrën e universit. Madje njeriu posedon një gjithëpërfshirës si qenia e një pikë qendrore për shfaqjen e njëmijë e një emrave të bukur hyjnorë.

A do të ishte e mundur për Atë që të dha ty këtë fytyrë dhe që vendosi në të një stampë të tillë mëshire dhe vulën e njësisë, të të lërë ty në tekat e tua, mos të të japë rëndësi, mos t'u kushtojë vëmendje veprave të tua, apo ta bënte të gjithë universin, i cili është kthyer drejt teje, kot më kot e pa qëllim, dhe ta bënte të kalbur pemën e krijimit, të parëndësishëm e me fruta të pri-shura? A do të ishte e mundur që Ai ta bënte mëshirën e Tij të mohohet, e cila është aq e qartë sa dielli, apo t'i shkaktonte urtësisë së Tij, e cila është e qartë si drita. të dyshohet, kur asnjëra prej tyre kurrësi nuk mund të dyshohet dhe nuk është e mangët? Ruana Zot! Jo, kurrë!..

Ti duhet ta dish së ndodhet një rrugë që ti të ngjitesh tek mëshira hyjnore dhe ajo është " Bismil'lahi - Rramani Rrahim". Në qoftë se dëshiron ta kuptosh se sa e rëndësishme është kjo rrugë ngjitjeje, shiko tek fillimi i njëqind e katërbëdhjetë kapitujve të Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe në krye të të gjithë librave të bekuar dhe tek fillimi i të gjitha punëve të bekuara, saqë përbën një provë vendimtare por madhështinë e Bismil'lah-it dhe për lartësinë e vlerës së saj, ajo që tha Imam Shafiu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, dhe dijetarët e mëdhenj të Islamit:

Megjithëse "Bismil'lahi - Rramani Rrahim" është një versët, ai është shpallur njëqind e katërbëdhjetë herë në Kur'an."

Shfaqja e unitetit hyjnor në krijesa është e pakufishme; atë nuk e rrethon gjithkush që thotë; vetëm Ty ne të adhurojmë", pra nuk do t'i mjaftonte gjithsecilit që e shpreh atë, sepse mendimi shpërndahet dhe breddh në atë shumësi, kështu do të duhej të ekzistonte një zemër aq e madhe sa globi tokësor për të vëzhguar krijuesin e vetëm e të pashoq nëpërmjet tërësisë së krijesave tek thënia "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë.

Duke u mbështetur mbi këtë mister të hollë, Allahu xh.sh. e demonstroi me qartësi vulën e njësisë hyjnore në çdo pjesë, ashtu siç e shfaq atë në çdo lloj; dhe kjo ndodh me qëllim që të tërhiqen shikimet për tek vetë Krijuesi i Vetëm dhe që të tregojë vulën e njësisë brenda stampës së gjithë mëshirshmërisë me qëllim që të mundet çdo person i çdo niveli të orientohet drejtpërdrejtë e pa ndonjë vështirësi në thënien e tij

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë" tek esenca e pastër dhe e shenjtë e të vetmit Krijues. Dhe me qëllim që të shprehet ky mister i madh

dhe të tregohet qartë vula e mëshirës hyjnore, Kur'ani i gjithurtë menjëherë përmend sferën më të vogël dhe çështjen më të veçantë kur përshkruan sferën më të madhe të universit.. Për shembull, kur Kur'ani shpjegon vërsetet e krijimit të qiejve e të tokës, ai i ndjek ato me vërsetet e krijimit të njeriut dhe shpjegon detajet e holla të mirësive në zërin e tij, dhe urtësinë në tiparet e tij që të mos shpërndahet mendimi në horizontet e mëdha, të mos mbytet zemra në shumësinë e pafund, dhe që shpirti ta gjejë drejtpërdrejtë të Adhuruarin e vërtetë pa ndërmjetësim.

Ajeti vijues e shpjegon këtë të vërtetë në mënyrë të mrekullueshme:

«Dhe nga treguesit e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe dallimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja.


Po, në të vërtetë, brenda krijesave të një shumësie të pafund ndodhen lloje dhe shkallë të vulave të unitetit hyjnor si rrathë bashkë qendrorë nga vula më e madhe për tek ajo më e vogla. Por, sado i qartë të jetë uniteti, ai ende është një unitet brenda shumësisë. Ai nuk mund t'u adresohet siç duhet vëzhguesve. Për shkak kësaj, duhet të jetë stampa e njësisë hyjnor prapa unitetit me qëllim që të hapë rrugën përpara zemrës për të arritur tek esenca e pastër dhe e shenjtë hyjnore pa i përkujtuar atij shumësinë.

Pastaj, me qëllim që të drejtohen shikimet drejt stampës së njësisë hyjnore dhe për të tërhequr zemrat drejt saj, është vendosur sipër saj një skalitje shumë e mrekullueshme dhe tërheqëse, një dritë shumë vezuluese, një ëmbëlsi shumë e shijshme, një bukuri e këndshme dhe një e vërtetë shumë e fuqishme, e cila është stampa e mëshirës hyjnore dhe vula e dhembshurisë hyjnore. Po, sigurisht, është fuqia e asaj mëshire. ajo që tërheq shikimet e qenieve lë vetëdijshme, që i sjell ato tek ajo dhe që u shkakton atyre të arrijnë vulën e njësisë dhe të vëzhgojnë të vetmin e pashoq, dhe nga ajo të shfaqet adresimi i vërtetë në: të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë.

Kështu, Bismil'lahi - Rramani Rrahim , meqenëse është indksi i sures El-Fatiha dhe një përmbledhje e shkurtër e Kur'anit, ajo u bë titulli dhe interpretuesi i këtij misteri të madh. Ai i cili e merr në dorë këtë titull mund të udhëtojë përmes niveleve të mëshirës hyjnore. Dhe ai i cili e bën këtë interpretues të flasë, mund të mësojë misteret e mëshirës hyjnore dhe shikon dritat e dhembshurisë dhe të përdëllimit hyjnor.

LET US BE UNITED FOR THE PRIORITIES OF THE RELIGIOUS FREEDOM

By the speech of the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, to the Ministerial on the religious freedom in Washington



I think that when we discuss about big challenges in the sense of the religious freedom, we have to be more open to accept the religions or the faiths of the others. The truth is that, generally, in the religious discourses, is admitted that we are, all of us, sons of Adam, that we have an Only God and that His Mercy and Generosity belong to all of us and are enough for all of us. You can hear this formulation from the most remote temples until in the urban hearts of our capitals and it sounds very prettily. But, a very ancient albanian proverb says: "There is a big river between saying and doing". So, there is a separating line, a very

clear one, between the academic realities, religious or secular ones, and the practical developments of the everyday life. I give a concrete example, dear friends!

In the quality of the World Bektashi Grandfather, since at least 8 years I have to deal with the destiny of the tekke of Tetova, in Northern Macedonia. Though this tekke owns all the regular papers of the Ottoman Empire, dating since 500 hundred years, proving that it belongs to the Bektashi community, it was usurped, by violence, 15 years ago, by a group of Sunnite extremists, Albanians like the Bektashi people which are the heirs of the tekke. Respecting our

tradition of religious harmony and peace, we contacted many times these extremists-usurpers, but we had not any concrete result. Meanwhile, we asked for help to the highest State institutions of the Northern Macedonia, to the leaders of the Islam Community in that country, as well as to all the diplomatic representatives accredited in Northern Macedonia, hoping to the removing away of the extremists and to the free practicing of our faith, but we did not found any solution. We asked also the judgment of the Strasbourg Court, which recognized our right which has been deprived for a long time, after the publication of many documents; a part of the tekke was burned by the barbarian extremists and we denounced this fact to the States Department of the USA, but the situation remains always a very tense one.

Paradoxally, even the Muslim Dijanet of Turkey, instead to give us the necessary help, keeps contacts with the usurpers of the tekke and makes plans to change its destination, converting the Bektashi tekke it in a Osman mosque.

We, the Bektashi people, we are not against the mosques. Indeed, the origin of the coexistence of a mosque with a tekke is our first tekke, opened 800 years ago in Haxhi Bektash, in Turkey. In



We, the Bektashi people, we are not against the mosques. Indeed, the origin of the coexistence of a mosque with a tekke is our first tekke, opened 800 years ago in Haxhi Bektash, in Turkey. In Asia and in Europe and especially in Balkans, in common territories, even nowadays, because of spiritual necessities of different communities, coexist yet mosques and tekkes, because, anyhow they belong to Islam, to His wonderful family.

Asia and in Europe and especially in Balkans, in common territories, even nowadays, because of spiritual necessities of different communities, coexist yet mosques and tekkes, because, anyhow they belong to Islam, to His wonderful family. But, when the mosque wants to mount up just to leave the tekke under the shadow (or, what is happening in Tetova, to annihilate the tekke), in such a case, we have to notice that the basic conceptions of the religious freedom are absent. In the foundations of the democracy is the famous idea "The end of my freedom is there where is the beginning of the freedom of the other people". Actually, in Northern Macedonia, even in these moments that we are speaking, a handful of extremists sunnites, not only have the courage to kill the religious freedom of the Bektashi community, but, strangely, they have the support of the Dijanet of Turkey, of the Islam



Community of Northern Macedonia and of other structures of that country which pretends, rightly, to have its place in the great european family. Here is, dear friends the reason why I spoke about this matter.

There are fire-places of terrorism in the Middle-East and we try to extinguish them. But other fire-places begin to burn in Balkans and we make as if we dont see them.



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.135 TETOR 2019

